



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORATI

Elbasan, me 19.02.2024

RELACION

Mbi realizimin e Planbuxhetit të vitit 2023 dhe Planbuxheti vjetor 2024 në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, VBA Nr. 10 datë 24.03.2023 “Për miratimin e planbuxhetit të vitit 2023”, i ndryshuar, shkresës së MAS (Email) datë 04.01.2024 në të cilin jepen fondet e miratuara për vitin 2024 (shkresa nr. 6 prot, datë 04.01.2024), për efekt të ndjekjes së likuiditeteve në fushën e menaxhimit, Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 1, datë 05.01.2024 “Për detajimin e fondeve (shpenzime korente) të miratuara për vitin 2024”, Shkresa Administratorit për Degën e Thesarit Elbasan nr. 138 prot, datë 19.01.2024 “Mbi përdorimin e të ardhurave të çelura për shpenzim në vitin 2023 dhe të pa përdorura e që trashëgohen për vitin 2024”, Shkresa Administratorit për Degën e Thesarit Elbasan nr. 139 prot, datë 19.01.2024 “Mbi fondin e grantit të arsimit të lartë të papërdorur gjatë vitit 2023, për tu mbartur në të njëjtën strukturë buxhetore në vitin 2024”, Shkresa Administratorit për Degën e Thesarit Elbasan nr. 3236/1 prot, datë 29.12.2023 “Kërkesë për çeljen e të ardhurave të grumbulluara deri më 29.12.2023” – rritje autorizimi nr. 2, datë 29.12.2023, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit i paraqitet “Realizim i planbuxhetit të vitit 2023 dhe planbuxheti vjetor 2024”.

A. Tregues të përgjithshëm

1. Të dhëna të përgjithshme mbi Universitetin e Elbasanit në lidhje me strukturën e përgjithshme organizative, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për vitin akademik 2023–2024 do të operojë në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik nr. 2 datë 31.01.2024 “Për miratimin e numrit të punonjësve, strukturës organizative dhe nivelit të pagave për çdo pozicion pune në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'”, Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 2 datë 10.02.2024 “Për miratimin e numrit të punonjësve, strukturës organizative dhe nivelit të pagave për çdo pozicion pune në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'”. Universiteti i Elbasanit ka në strukturën e tij organizative 376 punonjës. Ky personel është i planifikuar për t'u punësuar në Rektorat dhe 5 Fakultetet përbërëse të UE-së.




- 1.1. Rektorati i Universitetit të Elbasanit me Rektorin, zv/rektor, administrator përbëhet nga 87 personel ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personel administrativë të organizuar në drejtori/njësi dhe ku çdo drejtori ka në përbërje sektorë, si më poshtë:
- 1.1.1. Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i koordinimit
 - Sektori i marrëdhënieve me Jashtë
- 1.1.2. Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë
- Njësia e kurrikulave dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë
 - Sektori i IT-së
- 1.1.3. Drejtoria Juridike, Këshillimit të karrierës dhe ALUMNI
- Sektori juridik
 - Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI
- 1.1.4. Drejtoria e Burimeve njerëzore protokoll Arkiv
- 1.1.5. Drejtoria Ekonomike
- Sektori i menaxhimit të buxhetit
 - Sektori i shërbimit financiar
- 1.1.6. Drejtoria e Prokurimeve dhe Shërbimeve
- Sektori i prokurimeve
 - Sektori i shërbimeve
- 1.1.7. Biblioteka
- Sektori i klasifikimit
 - Sektori i arkivit
- 1.1.8. Auditi i brendshëm
- 1.2. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka në përbërjen e tij 5 (pesë) fakultete të ndara në departamente/qendra kërkimore. Struktura organizative ka në përbërje personel akademik, ndihmësakademik me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ. Fakultetet e UE-së janë të organizuar në departamente dhe kanë në përbërje krahas personelit akademik edhe personel ndihmës akademik/laborantë të cilët ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies. Pjesë përbërëse e strukturës së Fakultetit janë dhe sekretarë mësimorë e Specialist protokoll arkive. Njësitë bazë të secilit fakultet paraqiten:
- 1.2.1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës:
- Departamenti i Matematikës
 - Departamenti i Informatikës
 - Departamenti i Fizikës
 - Departamenti i Kimisë
 - Departamenti i Biologjisë
 - aboratori Eksperimental
- 1.2.2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike:
- Departamenti i Infermieristikës
 - Departamenti i Lëndëve Paraklinike
 - Departamenti i Lëndëve Klinike
 - Departamenti i specialiteteve tekniko mjekësore
- 1.2.3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit:
- Qendra për kërkim dhe zhvillim në Edukim
 - Departamenti i Shkencave Sociale dhe edukimi qytetar
- 1.2.4. Fakulteti i Shkencave Humane:
- Departamenti i Gjuhësisë
 - Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë
 - Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë
 - Departamenti i gjuhëve të huaja
 - Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike
 - Qendra/Laboratori i medias
- 1.2.5. Fakulteti Ekonomik:
- Departamenti i Administrim biznesit
 - Departamenti i Marketing Inxhinierisë
 - Departamenti i Financë Kontabilitetit
 - Departamenti i Ekonomiksit
 - Departamenti i së drejtës

- Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi

1.3. Autoritetet drejtuese të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” janë:

- Rektori
- Administratori
- Drejtues të njësive kryesore – Dekan fakulteti
- Drejtues të njësive bazë: Drejtues departamenti, Drejtues qendre kërkimore, Drejtues drejtorie

Fakultetet në vite




Numri i punonjësve në UE për vitin 2023 u parashikua rreth 389 personel akademikë dhe joakademikë (ndihmësakademikë me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ).

Për periudhën Janar–Dhjetor të vitit 2023 mesatarisht kanë punuar 323 punonjës nga të cilët; personel akademik kanë punuar 208 punonjës ose 64% e numrit mesatar gjithësej, personel ndihmësakademikë kanë punuar 80 punonjës ose 24% e numrit mesatar gjithësej,

Emertimi	Janar–Dhjetor të vitit 2023			
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	% e femrave
Gjithsej	323	120	203	63%
Drejtues	60	29	31	52%
Specialistë	241	84	157	65%
Punëtorë	22	7	15	68%

Numri i punonjësve mesatar Janar - Dhjetor 2023



personel administrativë kanë punuar 210 punonjës ose 11% e numrit mesatar gjithësej. Sipas raportimeve statistikore paraqiten të dhëna si më poshtë:



Për këtë periudhë nga personeli akademik mesatarisht 83% janë me tituj e grada dhe 17% pa tituj e grada. Raporti që zë personeli akademik me tituj e grada për këtë

Personeli akademikë mesatar Janar - Dhjetor Viti 2023




periudhë është në rritje nga viti i mëparshëm si rezultat i kualifikimit të vazhdueshëm të personelit ekzistues, si dhe rekrutimi i kualifikuar i personelit të punësuar rishtazi. Sipas statistikave nga të dhënat e mësipërme konstatohet se personeli femra përbën një peshë të rëndësishme në të gjitha strukturat me rreth 63% të personelit gjithësej, por edhe në funksionet drejtuese.

Numri i punonjësve në UE për vitin 2024 është parashikuar rreth **376 punonjës**, nga të cilët: personel akademik **247 punonjës** ose **66%** e numrit të përgjithshëm të punonjësve, personel ndihmësademikë **93 punonjës** ose **25%** e numrit të përgjithshëm të punonjësve, personel administrativë **36 punonjës** ose **9%** e numrit të përgjithshëm të punonjësve. Nga personeli akademik mesatarisht **85%** e tyre



parishikohet të jenë me tituj e grada dhe **15%** e tyre parashikohet të jenë pa tituj e grada.



2. Të dhëna të përgjithshme mbi: Ciklet dhe programet e studimit, numrin e studentëve, ngarkesën mësimore, shtrirjen territoriale të njësive akademike dhe mjediset

➤ Ciklet dhe programet e studimit, numrin e studentëve.

○ Ciklet dhe programet e studimit

Ciklet dhe programet e studimit në UE për vitin akademik 2022 – 2023. UE ofroi këto nivele e programe studimi:

- Programe studimi me karakter profesional
 - Programe studimi me karakter profesional me **8** programe studimi.
- Cikli i parë i studimeve Bachelor dhe Program i Integruar Master i Shkencave me **38** programe studimi,
 - Programe studimi Bachelor me **37** programe studimi.
 - Programe studimi të Integruara Master i Shkencave me **1** programe studimi.
- Cikli i dytë i studimeve me **53** programe studimi:

- Master profesional me **35** programe studimi,
- Master i shkencave me **18** programe studimi.
- Ciklin i tretë me **3** programe studimi.

Programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, kanë pësuar ndryshime në vite, ndërkohë që në vitin e parë akademik 2023 -2024 nuk janë hapur disa programe studimi, për arsye se nuk është plotësuar numri minimal ose nuk ka patur regjistrime.

Ciklet dhe programet e studimit në UE për vitin akademik 2023 – 2024. UE ofrojë këto nivele e programe studimi:

- Programe studimi me karakter profesional
 - Programe studimi me karakter profesional me **8** programe studimi.
- Cikli i parë i studimeve Bachelor dhe Program i Integruar Master i Shkencave me **38** programe studimi,
 - Programe studimi Bachelor me **37** programe studimi.
 - Programe studimi të Integruara Master i Shkencave me **1** programe studimi.
- Cikli i dytë i studimeve me **53** programe studimi:
 - Master profesional me **35** programe studimi,
 - Master i shkencave me **18** programe studimi.
 - Program i formimit të vazhduar me **1** programe studimi.
- Ciklin i tretë me **3** programe studimi.

Programet studimi në vitet 2005 - 2024

Nr	Emërtimi	Vitet															
		2005 2006	2008 2009	2010 2011	2011 2012	2012 2013	2013 2014	2014 2015	2015 2016	2017 2018	2018 2019	2019 2020	2020 2021	2021 2022	2022 2023	2023 2024	
1	Program me karakter profesional - Pkpr	0	0	0	1	1	1	1	1	1	5	7	7	7	8	8	
2	Program K.plotë-Bachelor - Bach	20	20	26	28	31	38	38	38	38	38	38	38	38	37	37	
3	Program K.pjesshme - Bachelor	11	11	14	14	14	15	15	15	0	0	0	0	0	0		
4	Program i integruar - PiMs	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1	1	
5	Koha e plotë - Mp	0	9	14	21	23	27	25	29	29	34	34	34	34	35	35	
6	Koha e pjesshme - Mp	0	0	0	3	9	14	14	0	0	0	0	0	0	0	0	
7	Koha e plotë - Msh	0	0	4	9	12	17	17	17	17	17	17	17	17	18	18	
8	Program i formimit të vazhduar - Pfv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	
9	Koha e plotë - Dr	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	3	3	
		31	40	58	78	92	114	112	102	87	96	98	99	99	102	103	

Programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” kanë pësuar ndryshime në vite me hapje programe të reja, ose ristrukturim të programeve të mëparshme, ndërkohë që në vitin e parë akademik 2023 -2024 nuk janë hapur disa programe studimi, për arsye se nuk është plotësuar numri minimal ose nuk ka patur regjistrime, kryesisht programet e studimit për mësuesi.

○ **Numri i studentëve për vitin akademik 2022 – 2023**

Në UE kanë studiuar për vitin akademik 2022 – 2023 dhe janë në vijimësi të studimeve nga vitet e mëparshme në të gjithë nivelet e studimeve **11,000** studentë nga të cilët **5,577 studentë në kohën normale** të studimit dhe **5,423 studentë të padiplomuar**:

- Në programet e studimit me karakter profesional janë **1,025 studentë**.
 - Në programet e studimit me karakter profesional janë **1,025 studentë**, nga të cilët **793 studentë në kohën normale** të studimit dhe **232 studentë të padiplomuar**



- Në Ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe Programe të Integruara Master i Shkencave janë **7,525 studentë**.
 - Në Ciklin e parë të studimeve Bachelor janë **7,353 studentë** nga të cilët **3,350 studentë në kohën normale** të studimit dhe **4,003 studentë të padiplomuar**.
 - Në Programe të Integruara Master i Shkencave janë **172 studentë** nga të cilët **172 studentë në kohën normale** të studimit dhe **0 studentë të padiplomuar**.
- Në Ciklin e dytë të studimeve janë **2,445 studentë**:
 - Në Master profesional janë **1,108 studentë**, nga të cilët **702 studentë në kohën normale** të studimit dhe **406 studentë të padiplomuar**,
 - Master i shkencave janë **1,337 studentë**, nga të cilët **786 studentë në kohën normale** të studimit dhe **551 studentë të padiplomuar**.
 - Program i formimit të vazhduar janë **0 studentë**.
- Në Ciklin e tretë të studimit në doktoraturë janë **35 studentë** nga të cilët **29 studentë në kohën normale** të studimit dhe **6 studentë të padiplomuar**.

Në numrin e përgjithshëm të studentëve përfshihen:

- Studentë që vijojnë studimet brenda kohëzgjatjes normale të programeve të studimit 5,577 studentë
- Të regjistruar në vitet e mëparshme, të cilët janë përsëritës të viteve të studimit ose kanë përfunduar vitet e studimeve dhe janë të padiplomuar 5,423 studentë. Për këta studentë janë evidentuar rastet që kanë paguar të paktën vitin e parë në Ciklin e parë të studimeve, ose kanë paguar të paktën këstin e parë në Ciklin të dytë të studimeve. Nga këta studentë janë paguar **273,119 mijë lekë**; ; tarifa shkollimi të vitit normal ose përsëritës për një ose disa vite nga studentët e ciklit të parë, këste të një ose të disa semestrave nga studentët e ciklit të dytë , tarifa për kredite të mbartura të studentëve që e kanë përfunduar kohën normale të studeimeve.

Numri i studentëve me fakultete brenda kohëzgjatjes normale dhe të padiplomuar 2022-2023													
Nr.	Sistemi	FE		FSHMT		FSHE		FSHH		FSHN		UE	
		Normal	Padipl	Normal	Padipl	Normal	Padipl	Normal	Padipl	Normal	Padipl	Normal	Padipl
1	Cikli i parë	437	1,471	1,903	703	631	829	258	696	659	761	3,888	4,460
-	Program Bachelor	437	1,471	1,903	703	485	812	116	645	228	495	3,169	4,126
-	Program 2 vjeçare	0	0	0	0	146	17	142	51	431	266	719	334
2	Cikli i dytë	355	340	421	253	583	296	32	17	97	51	1,488	957
a	Master profesional – Mp	88	123	101	76	473	189	0	0	40	18	702	406
-	Mp -60 kredite	88	123	101	76	48	38	0	0	0	0	237	237
-	Mp-120 kredite	0	0	0	0	425	151	0	0	40	18	465	169
b	Master i shkencave – Msh	267	217	320	177	110	107	32	17	57	33	786	551
3	DIND	172	0	0	0	0	0	0	0	0	0	172	0
4	Doktoraturë – Dr	0	0	17	0	0	0	12	6	0	0	29	6
	Totali i studentëve	964	1,811	2,341	956	1,214	1,125	302	719	756	812	5,577	5,423
	Totali i studentëve	2,775		3,297		2,339		1,021		1,568		11,000	

○ **Numri i studentëve për vitin akademik 2023 – 2024**

Në UE kanë studiuar për vitin akademik 2023 – 2024 dhe janë në vijimësi të studimeve nga vitet e mëparshme në të gjithë nivelet e studimeve **10,440 studentë** nga të cilët **5,368 studentë në kohën normale** të studimit dhe **5,072 studentë të padiplomuar**:

- Në programet e studimit me karakter profesional janë **932 studentë**.
 - Në programet e studimit me karakter profesional janë **932 studentë**, nga të cilët **688 studentë në kohën normale** të studimit dhe **244 studentë të padiplomuar**

- Në Ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe Programe të Integruara Master i Shkencave janë **7,168 studentë**.
 - Në Ciklin e parë të studimeve Bachelor janë **7,968 studentë** nga të cilët **3,025 studentë në kohën normale** të studimit dhe **3,963 studentë të padiplomuar**.
 - Në Programe të Integruara Master i Shkencave janë **200 studentë** nga të cilët **200 studentë në kohën normale** të studimit dhe **0 studentë të padiplomuar**.
- Në Ciklin e dytë të studimeve janë **2,295 studentë**:
 - Në Master profesional janë **985 studentë**, nga të cilët **610 studentë në kohën normale** të studimit dhe **375 studentë të padiplomuar**,
 - Master i shkencave janë **1,293 studentë**, nga të cilët **789 studentë në kohën normale** të studimit dhe **504 studentë të padiplomuar**.
 - Program i formimit të vazhduar janë **17 studentë**.
- Në Ciklin e tretë të studimit në doktoraturë janë **45 studentë** nga të cilët **39 studentë në kohën normale** të studimit dhe **6 studentë të padiplomuar**.

Në numrin e përgjithshëm të studentëve përfshihen:


- Studentë që vijojnë studimet brenda kohëzgjatjes normale të programeve të studimit 5,368 studentë
- Të regjistruar në vitet e mëparshme, të cilët janë përsëritës të viteve të studimit ose kanë përfunduar vitet e studimeve dhe janë të padiplomuar 5,072 studentë. Për këta studentë janë evidentuar rastet që kanë paguar të paktën vitin e parë në Ciklin e parë të studimeve, ose kanë paguar të paktën këstin e parë në Ciklin të dytë të studimeve. Nga këta studentë janë paguar **262,936 mijë lekë**; tarifa shkollimi të vitit normal ose përsëritës për një ose disa vite nga studentët e ciklit të parë, këste të një ose të disa semestrave nga studentët e ciklit të dytë, tarifa për kredite të mbartura të studentëve që e kanë përfunduar kohën normale të studeimeve.

Numri i studentëve me fakultete brenda kohëzgjatjes normale dhe të padiplomuar 2023-2024													
Nr.	Sistemi	FE		FSHMT		FSHE		FSHH		FSHN		UE	
		Nor mal	Pa dipl	Nor mal	Pa dipl	Nor mal	Pa dipl	Nor mal	Pa dipl	Nor mal	Pa dipl	Nor mal	Pa dipl
1	Program me karakter profesional	0	0	0	0	157	23	129	40	402	181	688	244
2	Cikli i parë dhe Integruara	563	1,441	1,838	628	463	770	106	612	255	492	3,225	3,943
-	Program Bachelor	363	1,441	1,838	628	463	770	106	612	255	492	3,025	3,943
-	Program i integruar - PiMs	200	0	0	0	0	0	0	0	0	0	200	0
3	Cikli i dytë	383	313	380	248	501	265	40	12	112	41	1,416	879
a	Master profesional – Mp	91	117	53	76	409	166	0	0	57	16	610	375
-	Mp -60 kredite	91	117	53	76	63	32	0	0	5	0	212	225
-	Mp-120 kredite	0	0	0	0	346	134	0	0	52	16	398	150
b	Master i shkencave – Msh	292	196	327	172	75	99	40	12	55	25	789	504
c	Program formimi vazhduar - Pfv	0		0		17		0		0		17	0
4	Cuikli i tretë Doktoraturë – Dr	0	0	27	0	0	0	12	6	0	0	39	6
	Totali i studentëve	946	1,754	2,245	876	1,121	1,058	287	670	769	714	5,368	5,072
	Totali i studentëve	2,700		3,121		2,179		957		1,483		10,440	



Pagesa e detyrimeve nga studentët e padiplomuar 000/lekë							
nr.	Sistemi	FE	FI	FSHE	FSHH	FSHN	UE
1	Program me karakter profesional	0	0	513	935	4,350	5,797
2	Cikli i parë dhe Integruara	70,199	28,375	36,434	33,410	19,664	188,083
-	Program Bachelor	70,199	28,375	36,434	33,410	19,664	188,083
-	Program i integruar - PiMs	0	0	0	0	0	0
3	Cikli i dytë	24,175	19,549	20,155	1,480	3,141	68,501
a	Master profesional – Mp	5,669	3,877	10,578	0	936	21,060
-	Mp -60 kredite	5,669	3,877	1,597	0	0	11,143
-	Mp-120 kredite	0	0	8,981	0	936	9,917
b	Master i shkencave – Msh	18,506	15,672	9,577	1,480	2,205	47,441
c	Program formimi vazhduar - Pfv						
4	Cikli i tretë Doktoraturë – Dr	0	0	0	555	0	555
	Total UE	94,375	47,924	57,102	36,381	27,154	262,936

Numri i studentëve sipas hapjes së sistemeve dhe cikleve të studimit



➤ Ngarkesa mësimore e personelit akademik

Në UE për vitin akademik 2022 – 2023 u parashikua të realizohen 122,739 orë mësimore mbi të cilat llogaritet pagesa e tyre, sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”. Nga orët e përlllogaritura parashikohet të realizohen:

- Nga personeli akademik efektivë 95,359 orë mësimore të pagueshme, nga të cilat orë mësimore të normuara 82,328 orë mësimore dhe jashtë auditori të pagueshme 13,031 orë mësimore. Personeli akademik efektiv parashikohet të mbulojë brenda normës së ngarkesës 36,389 orë mësimore, ndërsa orët mbi normë në auditor parashikohen 45,939 orë mësimore dhe jashtë auditori 13,031 orë mësimore, gjithsej 58,970 orë mësimore të pagueshme. Për personelin akademik efektiv me Vendim të Bordit të Administrimit vendoset të paguhet për secilin deri në 300 orë mësimore në auditor e jashtë auditori, pasi të jenë plotësuar minimumi 1,536 orë

pune vjetore. Këtij personeli parashikohet ti paguhen mbi normën e parashikuar gjithsej 55,089 orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit.

- Nga personeli akademik në FSHE-së me vendim të Senatit Akademik funksionon sistemi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë për të cilin parashikohen rreth 4,320 orë trajnimi të punonjësve arsimorë, e cila do të jetë mbi ngarkesën në auditor për secilin trajnues. Ky proces do të kryhet nga 18 trajnues për 18 module.

- Nga personeli akademik i ftuar (të jashtëm) parashikohet të realizohen 27,380 orë mësimore.

Në UE për vitin akademik 2022-2023 u realizuan gjithsej 329,501 orë mësimore nga të cilat: nga personeli akademik efektiv u realizuan gjithsej 295,628 orë mësimore, ndërsa nga personeli akademik i ftuar (të jashtëm) 33,873 orë mësimore.

Në vitin akademik 2022–2023 u realizuan 123,245 orë mësimore të pagueshme mbi të cilat llogaritet pagesa e tyre, sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”:

- Personeli akademik efektiv ka realizuar 89,372 orë mësimore të pagueshme, nga të cilat orë mësimore të normuara në auditor 78,501 orë mësimore dhe jashtë auditori të pagueshme 10,871 orë mësimore. Norma e përlllogaritur e personelit efektiv është 29,730 orë mësimore, ndërsa orët mbi normë në auditor e jashtë auditori janë realizuar 59,642 orë mësimore të pagueshme. Për personelin akademik efektiv me Vendim të Bordit të Administrimit u vendos të paguhet për secilin deri në 300 orë mësimore në auditor e jashtë auditori, pasi të jenë plotësuar minimumi 1,536 orë pune vjetore. Këtij personeli janë paguar mbi normën e parashikuar gjithsej 53,278 orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit.

- Në vitin akademik 2022–2023 u realizuan nga personeli akademik i ftuar (të jashtëm) gjithsej 33,873 orë mësimore dhe janë paguar për 32,155 orë mësimore, brenda normës së parashikuar në udhëzimin e mësipërm.

- Nga personeli akademik efektivë pranë FSHE-së me vendim të Senatit Akademik funksionon sistemi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë për të cilin janë realizuar rreth 198 orë trajnimi të punonjësve arsimorë, e cila do të jetë mbi ngarkesën në auditor për secilin trajnues, të cilat janë paguar me buxhetin e vitit 2023.

Në vitin akademik 2023 – 2024 parashikohet të realizohen **121,157 orë mësimore** mbi të cilat llogaritet pagesa e tyre, sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”. Nga orët e përlllogaritura parashikohet të realizohen:


- Nga personeli akademik efektivë 95,308 orë mësimore të pagueshme, nga të cilat orë mësimore të normuara 82,727 orë mësimore dhe jashtë auditori të pagueshme 12,580 orë mësimore. Personeli akademik efektiv parashikohet të mbulojë brenda normës së ngarkesës 35,670 orë mësimore, ndërsa orët mbi normë në auditor parashikohen 42,920 orë mësimore dhe jashtë auditori 12,580 orë mësimore, gjithsej 55,500 orë mësimore të pagueshme. Për personelin akademik efektiv me Vendim të Bordit të Administrimit vendoset të paguhet për secilin deri në 300 orë mësimore në auditor e jashtë auditori, pasi të jenë plotësuar minimumi 1,536 orë pune vjetore. Këtij personeli parashikohet ti paguhen mbi normën e parashikuar gjithsej 74,100 orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit.

- Nga personeli akademik në FSHE-së me vendim të Senatit Akademik funksionon sistemi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë për të cilin parashikohen rreth 4,320 orë trajnimi të punonjësve arsimorë, e cila do të jetë mbi ngarkesën në auditor për secilin trajnues. Ky proces do të kryhet nga 18 trajnues për 18 module.

- Nga personeli akademik i ftuar (të jashtëm) parashikohet të realizohen 25,850 orë mësimore.

➤ **Shtrirja territoriale të njësive akademike dhe mjediset**

UE e ushtron veprimtarinë e tij akademike e kërkimore, pothuajse në të gjithë territorin e qytetit të Elbasanit, edhe në periferi të tij (Njësia Administrative Bradashesh). Aktualisht UE ka në administrim (vlerë kontabël) 12 godina dhe është kryer procedura e kalimit në pronësi të universitetit dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP.



Janë regjistruar godinat së bashku me truallin tek FSHMT dhe është në proces prokurimi ndërtimi i një godine me tërë parametrat e kohës në këtë fakultet me dy kate parkimi. Është regjistruar godina e FSHH (ish materniteti), Laboratorit kërkimor i FSHN (metalurgji) dhe teritorro i Krastës. Po vazhdon puna për legalizimin e shtesave dhe regjistrimin e godinave ekzistuese

të ndërtuara para ndryshimit të sistemit.

Fakultetet	Siperfaqja m ²		Nr. Studentëve	Siperfaqja m ² për student
	Gjithsej	mësimore		
<i>Godina e Korpusit Kryesor</i>	7,127	3,403		0.0
<i>Godina e Laboratorit Shkencor</i>	1,884	1,180		0.0
<i>Godina e akademikëve</i>	865	81		0.0
<i>Godina e Bibliotekës</i>	1,680	972		0.0
FSHN+FSHH	11,556	5,636	1,056	5.3
<i>Godina e Fakultetit shk. Edukimit</i>	3,023	1,709		0.0
<i>Objekt me Qira</i>	1,000	1,000		0.0
<i>Palestra</i>	418	374		0.0
FSHE	4,441	3,083	1,121	2.0
<i>Godina e Fakultetit Ekonomik</i>	3,144	1,865		0.0
FE	3,144	1,865	946	1.9
<i>Godina e FSHMT</i>	2,942	1,876		0.0
FSHMT	2,942	1,876	2,245	0.8
<i>Rektorati</i>	924	0		0.0
<i>Godina FSHH(Ish maternitet)</i>	1,313	0		0.0
Shuma	24,320	12,460	5,368	2.3

Siperfaqja e mjediseve mësimore paraqitet mesatarisht 2.3 m² për student, ndërkohë që sipas godinave paraqitet nga 0.8 m²/student deri në 5.3 m²/student:

Në FSHMT është e nevojshme kryerja e ndërtimit të godinës së re, pasi sipërfaqja e mjediseve mësimore është 0.8 m²/student.

NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE - REALIZIMI - "VITI 2022 - 2023"

Nr	FAKUL TETI	Nr. Student të kohës normale	Nr. P/Akademik			Mësimdhënie e pagueshme				Orë mësimore gjithsej			Mbulimi me personel akademik						
						E normuar		Jashtë audit. Brend	Gjithsej				Të brendshëm			Norma Jashtëm	Pagesa		
			Brend.	Jasht.	Gjith se	Brend.	Jasht.			Norma	Mbi norma Jash. Audit	Limiti	Brend.	Jasht.	Shuma				
1	FE	964	43	66	109	16,243	5,444	2,824	24,511	64,609	5,444	70,053	5,643	13,424	12,900	7,920	12,155	5,257	17,412
2	FSHMT	2,341	40	120	160	17,614	11,739	2,405	31,758	61,827	11,739	73,566	6,565	13,454	12,000	14,400	11,707	10,965	22,672
3	FSHE	1,214	39	57	96	15,237	6,449	2,204	23,890	56,078	6,449	62,527	4,918	12,523	11,700	6,840	11,297	6,065	17,362
4	FSHH	302	54	30	84	15,563	2,514	1,394	19,471	59,511	2,514	62,025	7,593	9,364	16,200	3,600	8,971	2,436	11,407
5	FSHN	756	35	68	103	13,844	7,727	2,044	23,615	53,603	7,727	61,330	5,011	10,877	10,500	8,160	9,148	7,432	16,580
	TOTALI	5,577	211	341	552	78,501	33,873	10,871	123,245	295,628	33,873	329,501	29,730	59,642	63,300	40,920	53,278	32,155	85,433

Norma mesatare e ngarkesës	141	orë mësimore	Orë të pa mbuluara nga personeli efektiv	93,515	orë mësimore
Norma e ngarkesës të jashtëm	99	orë mësimore	Orë të pagueshme nga personeli efektiv	70,513	orë mësimore
% që mbulon stafi efektiv mbi normë	164	%	Numri i personelit efektiv	557	Punonjës
% që mbulon stafi efektiv gjithsej	64	%	Numri i personelit jo efektiv	341	Punonjës
% që mbulon stafi jashtëm	27	%	Numri i personelit gjithsej	898	Punonjës
			Numri i punonjësve efektiv gjithsej (normën mesatare)	875	Punonjës

NUMRI I STUDENTEVE DHE NGARKESA MËSIMORE - parashikimi - "VITI 2023 - 2024"

Nr	FAKUL TETI	Nr. Student të kohës normale	Nr. P/Akademik			Mësimdhënie e pagueshme				Orë mësimore gjithsej			Mbulimi me personel akademik						
						E normuar		Jashtë audit. Brend	Gjithsej				Të brendshëm			Norma Jashtëm	Për Pagesë		
			Brend.	Jasht.	Gjith se	Brend.	Jasht.			Norma	Mbi norma Jash. Audit	Limiti	Brend.	Jasht.	Shuma				
1	FE	946	48	40	88	16,444	4,838	3,094	24,376	63,403	4,838	68,241	6,468	13,069	14,400	4,838	13,069	4,838	17,908
2	FSHMT	2,245	65	42	107	23,087	5,062	3,748	31,897	59,292	5,062	64,354	10,690	16,145	19,500	5,062	16,145	5,062	21,207
3	FSHE	1,121	42	42	84	15,029	4,995	2,192	22,216	51,782	4,995	56,777	5,413	11,808	12,600	4,995	11,808	4,995	16,803
4	FSHH	287	55	62	117	9,786	7,393	1,349	18,528	56,555	7,393	63,948	7,758	3,378	16,500	7,393	3,378	7,393	10,770
5	FSHN	769	37	30	67	18,381	3,561	2,198	24,140	54,525	3,561	58,086	5,341	15,238	11,100	3,561	11,100	3,561	14,661
	TOTALI	5,368	247	215	462	82,727	25,850	12,580	121,157	285,556	25,850	311,406	35,670	59,638	74,100	25,850	55,500	25,850	81,350

Norma mesatare e ngarkesës efektiv	144	orë mësimore	Orë të pa mbuluara nga personeli efektiv	85,487	orë mësimore
Norma e ngarkesës të jashtëm	120	orë mësimore	Orë të pagueshme nga personeli efektiv	72,218	orë mësimore
% që mbulon stafi efektiv mbi normë	244	%	Numri i personelit efektiv	573	Punonjës
% që mbulon stafi efektiv gjithsej	85	%	Numri i personelit jo efektiv	215	Punonjës
% që mbulon stafi jashtëm	15	%	Numri i personelit gjithsej	788	Punonjës
			Numri i punonjësve efektiv gjithsej (normën mesatare)	839	Punonjës

B. Realizimi i planbuxhetit të vitit 2023

Planbuxheti i planifikuar në vitin 2023 është në vlerën **2,307,043** mijë lekë, i cili përbëhet nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe plani i grumbullimit të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Fonde të mbartura, financime nga Grantet dhe të ardhura për vitin 2023 - Plan				000/Lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2022	Financimi i vitit 2023	Buxheti viti 2023
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	475,033	1,207,673	1,682,706
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	5,054	30,616	35,671
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	418,667	170,000	588,667
TOTALI		898,754	1,408,290	2,307,043

- Plani i **Financimeve nga Buxheti i Shtetit** (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, Kërkimi shkencor nga buxheti AKKSHI) është në vlerën **1,682,706** mijë lekë.
- Plani i **Projekteve të huaja për disbursim** është në vlerën **35,671** mijë lekë,
- Plani i **Të ardhura të institucionit** (Grumbullimi i të ardhurave të vitit, të trashëguara nga vitet e mëparëshme dhe të ngurtësuara për përdorim vitet e ardhshme) janë në vlerën **588,667** mijë lekë.

Buxheti i akorduar e i çelur për përdorim në vitin 2023 është në vlerën **1,814,865** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi në fakt i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Fonde të mbartura, financime nga Grantet dhe të ardhura për vitin 2023 - Fakt					000/Lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2022	Shtesa viti 2023	Pakësime viti 2023	Buxheti viti 2023
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	475,033	1,207,673	149,785	1,532,921
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	5,054	10,308	0	15,362
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	418,667	129,257	281,342	266,582
TOTALI		898,754	1,347,239	431,127	1,814,865

- Fakti i **Financimeve nga Buxheti i Shtetit** (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, Kërkimi shkencor nga buxheti AKKSHI) është në vlerën **1,532,921** mijë lekë.
- Fakti i disbursimeve të **Projekteve të huaja** është në vlerën **15,362** mijë lekë,
- **Të ardhura të institucionit** (Grumbullimi i të ardhurave të vitit, të trashëguara nga vitet e mëparëshme dhe të ngurtësuara për përdorim vitet e ardhshme) janë në vlerën **266,582** mijë lekë.

1. Hyrjet e fondeve për vitin 2023

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2023 buxheti i akorduar është në vlerën **1,814,865** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:



Tabela nr.1

BUXHETI 12 mujori viti 2023 fakti

000/Lekë

Nr	Fonde të hyra				Shpenzime			
	Emërtimi i programit	Buxheti vjetor	Akorduar	në %	Emërtimi i programit	Çelur për përdorim - Plan	fakt	në %
1	Grant konkurrues	118,000	0	0.00	Grant konkurrues	0	0	0.00
2	Kërkim shkencor infrastruktura AKKSHI	31,785	0	0.00	Kërkim shkencor infrastruktura AKKSHI	0	0	0.00
3	Buxhet -TVSH projekte të huaja	130	130	100.00	Buxhet -TVSH projekte të huaja	130	130	100.00
I	Buxheti i brendshëm	149,915	130	0.09	Buxheti i brendshëm	130	130	100.00
1	Grant mësimdhënie cikli parë	1,371,478	1,371,478	100.00	Grant mësimdhënie cikli parë	1,371,478	698,892	50.96
2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	148,131	148,131	100.00	Granti i bursave të studentëve cikli parë	148,131	148,091	99.97
3	Mbështetje financiare nga fondi ekselences	680	680	100.00	Mbështetje financiare nga fondi ekselences	680	680	100.00
4	Kërkim shkencor AKKSHI	12,503	12,503	100.00	Kërkim shkencor AKKSHI	12,503	7,336	58.67
II	Grant	1,532,791	1,532,791	100.00	Grant	1,532,791	854,998	55.78
1	Të ardhurat e trashëguara viti 2022	418,667	418,667	100.00		0	0	0.00
2	Të ardhura jashtë limiti viti 2023	170,000	129,257	76.03	Të ardhura	266,582	63,788	23.93
III	Të ardhura	588,667	547,924	93.08	Të ardhura	266,582	63,788	23.93
1	Projekti të huaja	35,671	15,362	43.07	Projekti të huaja	15,362	12,645	82.31
IV	Projekti të huaja	35,671	15,362	43.07	Projekti të huaja	15,362	12,645	82.31
	Totali	2,307,043	2,096,207	90.86	Totali	1,814,865	931,561	51.33

- Fondet e hyra nga Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, Kërkim shkencor infrastruktura AKKSHI, TVSH projekte të huaja) janë në vlerën **149,915 mijë** lekë, ndërkohë me rialokimet deri në fund të vitit janë realizuar **130 mijë** lekë ose 0.⁰⁹ %. Këto fonde nuk trashëgohen në vitin pasardhës. Ky buxhet është shpenzuar për TVSH për projekte të huaja në vlerën **130 mijë** lekë, ose 100.⁰⁰ % e fondit të akorduar.
- Fondet e hyra nga Granti (Grant mësimdhënie cikli parë, Granti i bursave të studentëve cikli parë, Mbështetje financiare nga fondi ekselences, Kërkim shkencor AKKSHI) janë në vlerën **1,532,791 mijë** lekë ose 100.⁰⁰ % e tyre. Ky buxhet është shpenzuar në vlerën **854,998 mijë** lekë, ose 55.⁷⁸ % e fondit të akorduar. Fondet e pashpenzuara të grantit trashëgohen në vitin pasardhës.
- Fondet e hyra nga të ardhura të institucionit (të grumbulluara gjatë vitit dhe të trashëguara nga vitet e mëparëshme), janë në vlerën **547,924 mijë** lekë ose 93.⁰⁸ %. Të ardhurat e trashëguara nga vitet e mëparëshme në vlerën **322,085 mijë** lekë janë ngurtësuar në Degën e Thesarit për financimin e objektivit "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT" në vitin pasardhës. Fondet e pashpenzuara nga të ardhura të institucionit, trashëgohen në vitin pasardhës.
- Ky buxhet është shpenzuar në vlerën **63,788 mijë** lekë, ose 23.⁹³ % e fondit të çelur për përdorim për vitin 2023.
- Fondet e hyra nga Projekte të huaja janë **15,362 mijë** lekë, ose 43.⁰⁷ % e fondit të planifikuar. Këto fonde janë shpenzuar në vlerën **12,645 mijë** lekë, ose 82.³¹ % e fondit të disbursuar.




Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: Tabela 2 - “Të Ardhurat për viti 2023 - fakti”, Tabela 3 - “Realizimi i Buxhetit për vitin 2023 - Fakti ”

Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e UE - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën **547,958 mijë** lekë ose 93.⁰⁸ % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa realizimi i të ardhurave të vitit 2023 është **129,291 mijë** lekë ose 76.⁰⁵ % e planit vjetor të tyre.

Tabela 2 Të Ardhurat për viti 2023 - fakti

Krijimi				
Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	170,000	129,291	76.1
1	Qira	350	336	95.9
2	Programe profesionale -Pkp	9,240	8,634	93.4
3	Bachelor - Bach	44,518	29,837	67.0
4	Program Integruar - PiMs	2,955	975	33.0
5	Master profesional - Mp	39,722	35,424	89.2
6	Master i shkencave - Msh	52,479	41,518	79.1
7	Doktoraturë - Dr	4,350	1,050	24.1
8	Trajnim mësues	500	297	59.4
9	Libreza Diploma etj.	3,397	1,940	57.1
10	Lëshim dokumenti	4,158	2,642	63.5
11	Taksë regjstrimi	4,331	4,344	100.3
12	Tarifa konkurimi	500	401	80.2
13	Tjera - shërbime	2,000	1,263	63.2
14	Pjesm. konferenca	500	51	10.2
15	Sponsorizime	1,000	580	58.0
B	Të ardhura të trashguara	418,667	418,667	100.00
1	Trashëguar nga vitet parardh	418,667	418,667	100.00
Totali		588,667	547,958	93.1

Realizimi prej 93.⁰⁸ % është rezultat i grumbullimit i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2023 në tetor–dhjetor 2022. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2022. Pjesa e papërdorur ka kaluar e ardhur e trashëguar e viteve të mëparshme për vitin 2023.



Grumbullimi i të ardhurave gjatë periudhës janar – dhjetor 2023 është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria ekonomike dhe strukturat e fakulteteve.


Grupimet më kryesore të të ardhurave janë realizuar:

- Tarifa shkollimi 91.⁵⁰ %
- Tarifa rregjistrimi 3.⁴⁰ %
- Tarifa konkurimi 0.³⁰ %
- Të ardhura Qira 0.²⁰ %
- Të tjera 4.⁶⁰ %

Në zërat e të ardhurave peshën kryesore e zënë:

- Tarifa nga Qira me 0.²⁰ % e të ardhurave të realizuara, ose 95.⁹⁴ % e planifikimit.

- Tarifat e shkollimit nga programet profesionale në nivelin 6.7% e të ardhurave të realizuara, ose 93.44% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga programet bachelor në nivelin 23.1% e të ardhurave të realizuara, ose 67.02% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga programet e integruara – MiMs në nivelin 0.8% e të ardhurave të realizuara, ose 33.99% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga programet master profesionale në nivelin 27.40% e të ardhurave të realizuara, ose 89.18% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga programet master i shkencave në nivelin 32.10% e të ardhurave të realizuara, ose 79.11% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga trajnimi i mësuesve në nivelin 0.20% e të ardhurave të realizuara, ose 59.40% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Tarifat e shkollimit nga doktoratura në nivelin 0.80% e të ardhurave të realizuara, ose 24.14% e planifikimit vjetor të të ardhurave.
- Libreza e diploma në nivelin 1.50% e të të ardhurave të realizuara, ose 57.11% e planifikimit vjetor të të ardhurave,
- Lëshim dokumenti në nivelin 2.00% e të ardhurave të realizuara, ose 63.53% e planifikimit vjetor të të ardhurave, kryesisht një peshë të rëndësishme zenë programet mësimore.
- Tarifa regjistrimi në nivelin 3.40% e të ardhurave të realizuara, ose 100.28% e planifikimit vjetor të të ardhurave,
- Tarifa konkurimi në nivelin 0.30% e të ardhurave të realizuara, ose 80.20% e planifikimit vjetor të të ardhurave;
- Shërbime të ndryshme ndaj studentëve dhe të tretë-ve në nivelin 1.00% e të ardhurave të realizuara, ose 63.15% e planifikimit vjetor të të ardhurave;
- Pjesmarrje në konferenca në nivelin 0.01% e të ardhurave të realizuara, ose 10.20% e planifikimit vjetor të të ardhurave,
- Sponsorizime janë trajtuar financimet e Universiteteve të huaja për shpenzime operative në kuadër të bashkëpunimit në nivelin 0.70% e të ardhurave të realizuara, ose 57.97% e planifikimit vjetor të të ardhurave



Në mos realizimin e parashikuar të të ardhurave kanë ndikuar:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë i tarifës së shkollimit.
- Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 62,016 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme
- Nuk janë shlyer në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Nuk janë hapur disa programeve në MP e MSH për vitin e parë si rezultat i mos plotësimit të numrit minimal të regjistrimeve. Për këto programe është planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Nuk janë hapur e disa programeve në Bachelor me kohë të plotë për vitin e parë për shkak të numrit minimal të regjistrimeve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.
- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM – s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë i tarifës së shkollimit.

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023
000/lekë

Nr	DEGA	I parë		I dytë		I tretë		Total	
		Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
1	Reduktim tarife me 50% - Bach&Pkpr (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	770	9,625	198	2,475	120	1,500	1,088	13,600
2	Reduktim tarife me 50% - Integruara PiMs (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	19	285	9	135	14	210	42	630
3	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate - Bach+Pkpr	35	875	28	700	33	825	96	2,400
4	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate - PiMs	4	120	7	210	4	120	15	450
5	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera - Bach+Pkpr	481	12,025	535	13,375	324	8,100	1,340	33,500
6	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera - PiMs	4	120	23	690	21	630	48	1,440
I	Cikli parë i studimeve + PiMs Totali	1,313	23,050	800	17,585	516	11,385	2,629	52,020
1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	6	180	30	900	0	0	36	1,080
2	Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	67	2,010	25	750	0	0	92	2,760
II.1	Total MP	73	2,190	55	1,650	0	0	128	3,840
1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	21	756	45	1,620	0	0	66	2,376
2	Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	53	1,908	52	1,872	0	0	105	3,780
II.2	Total MSH	74	2,664	97	3,492	0	0	171	6,156
II	Cikli dytë i studimeve Totali	147	4,854	152	5,142	0	0	299	9,996
	Total UE	1,460	27,904	952	22,727	516	11,385	2,928	62,016

Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2023 janë **129,291 mijë lekë**, nga të cilat i takojnë institucionit **129,257 mijë lekë**. Nga këto të ardhura janë çelur për përdorim gjatë këtij viti në vlerën **30,000 mijë lekë**. Nga të ardhurat e çelura në vite, që janë transferuar për përdorim për vitin 2023, si dhe ato të çelura gjatë këtij viti janë përdorur në vlerën 63,788 mijë lekë, sipas ndarjeve në tabelë, ose grafikisht:

- Studime e projektme – (230) vlera 0 mijë lekë ose 0.⁰⁰ % e të ardhurave të përdorura,
- Investime trupëzuara – (231) vlera 11,051 mijë lekë ose 17.³² % e të ardhurave të përdorura,




- Paga e shpërblime – (600) vlera 33,418 mijë lekë ose 52.³⁹ % e të ardhurave të përdorura,
- Shpenzime operative – (602) vlera 345 mijë lekë ose 0.⁵⁴ % e të ardhurave të përdorura
- Transferta me jashtë – (605) vlera 153 mijë lekë ose 0.²⁴ % e të ardhurave të përdorura,
- Transferta tek individë – (606), kryesisht rimbursim i tarifave të shkollimit vlera 354 mijë lekë ose 0.⁵⁵ % e të ardhurave të përdorura,
- Kërkim shkencor – (230) vlera 0.00 mijë lekë ose 0.⁰⁰ % e të ardhurave të përdorura,
- Kërkim shkencor – (602) vlera 18,445 mijë lekë ose 28.⁹² % e të ardhurave të përdorura,
- Kërkim shkencor – (606) vlera 0.⁰⁰ mijë lekë ose 0.⁰⁰ % e të ardhurave të përdorura,

Nr.	Emërtimi	000/lekë	%
1	Studime e projekte-230	0	0. ⁰⁰ %
2	Investime trupëzuara-231	11,051	17. ³² %
3	Paga e shpërblime-600	33,418	52. ³⁹ %
4	Shpenzime operative-602	345	0. ⁵⁴ %
5	Transf. me jashtë-605	153	0. ²⁴ %
6	Transf. individët-606	354	0. ⁵⁵ %
7	Kërkimi shkencor-230	0	0. ⁰⁰ %
8	Kërkimi shkencor-602	18,445	28. ⁹² %
9	Kërkimi shkencor-606	0	0. ⁰⁰ %
Totali		63,788	100. ⁰⁰ %

Të ardhurat e trashëguara në vite, të çelura për përdorim gjatë vitit 2023 e të papërdorura janë në vlerën 418,667 mijë lekë që transferohen, ndërsa të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2023 të paçelura për përdorim janë në vlerën 99,257 mijë lekë, gjithsej në vlerën 484,136 mijë lekë që transferohen për përdorim për vitin 2024.

Derdhen në Buxhet të ardhurat në vlerën 34 mijë lekë (10 % e të ardhurave nga qiratë dhe arkëtime



nga debitorë të ndryshëm).

Të ardhurat janë çelur për përdorim sipas ndarjeve në planbuxhetin e vitit 2023 për Universitetin, mbështetur në domosdoshmërinë për shpenzim për çdo artikull dhe kontratave të lidhura e të realizuara në investime e shpenzime operative, si dhe për shpenzime të tjera korente. Të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit 2023 të paçelura për përdorim gjatë këtij viti janë transferuar për përdorim

për vitin 2024 për investime dhe kërkim shkencor sipas listës së projektëve në PBA-në e viteve 2024-2026.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka arkëtuar të ardhura për periudhën 2016-2023 sipas disa grup zërave të mëposhtme:

Të Ardhurat për vitet 2016-2023 - fakti

Nr	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
A	Të ardhura të vitit	259,533	299,364	268,414	168,461	153,488	147,107	136,296	129,291
1	Qira	502	520	486	377	124	123	317	336
2	Programe profesionale	0	0	0	0	0	0	5,763	8,634
3	Bachelor - Bach	139,035	164,038	139,822	62,722	66,414	50,289	35,938	29,837
4	Program Integruar - PiMs	0	0	0	0	0	0	814	975
5	Master profesional - Mp	56,922	61,363	57,921	47,953	40,710	47,818	40,414	35,424
6	Master i shkencave - Msh	37,281	44,611	46,428	41,349	29,014	34,204	39,310	41,518
7	Doktoraturë - Dr	0	0	0	0	0	49	146	1,050
8	Trajnim mësues	139	486	347	108	0	625	0	297
9	Libreza Diploma etj.	11,153	14,333	10,849	4,171	2,909	2,639	2,404	1,940
10	Lëshim dokumenti	2,718	4,187	4,379	3,714	2,599	3,748	3,759	2,642
11	Taksë regjstrimi	7,698	6,888	5,786	5,272	5,155	5,107	4,437	4,344
12	Tarifa konkurimi	511	414	420	415	485	550	450	401
13	Tjera - shërbime	590	995	744	1,747	1,889	1,424	1,238	1,263
14	Pjesm. konferenca	2,984	1,353	948	0	5	130	319	51
4 (270)	"Studimi i emigrimit tek të rinjtë e qarkut Elbasanit: arsyet, kostot dhe mënyrat e zbutjes" - Prof. As. Dr. Alketa Vangjeli	988	988	100.00	731	731	100.00	988	988	0	FE			
5 (271)	"Modernizimi i praktikave profesionale përmes hartimit të një kornize kompetencash profesionale për studentët kandidatë për mësues." - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	1,364	1,332	97.63	1,074	1,042	96.99	1,524	1,364	160	FSHE			
6 (273)	"Marrëdhënia midis tipologjive të dhunës në familje dhe variabla psiko-socialë." - Dr.Roksana Poçi	921	880	95.54	649	608	93.67	921	921	10	FSHE			
7 (278)	"Evidentimi e vlerësimi floristik i Parkut Kombëtar "Shebenik" si dhe ngritja e kapaciteteve bashkëpunuese me Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan.." - Dr. Ermelinda Gjeta	1,296	1,295	99.90	746	745	99.83	1,640	1,296	344	FSHN			
8 (279)	"Mbi studimin dhe vlerësimin e shëndetit mendor në periudhën post COVID, në grupmoshat 15-24 vjeç." - Dr. Gjergji Koja	1,529	1,528	99.96	592	592	100.00	1,744	1,529	215	FSHMT			



Nr. (PBA)	Emërtimi i projektit	AKKSHI						Projekti Total			Njesia
		Totale			Viti 2023			Vlera	AKKSHI	UE	
		Plan	Fakti	%	Plan	Fakti	%				
9 (296)	"Identifikimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë në performancën akademike të studentëve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" bazuar në mënyrën e zakoneve apo të sjelljes së të mësuarit, strategjitë e përmirësimit" - Dr. Liljana Ramasaço	1,940	985	50.80	1,203	985	81.93	2,055	1,940	115	FSHMT
10 (297)	"Rritja e ndergjegjesimit te edukimit financiar tek të rinjte në Qarkun e Elbasanit " - Dr Eliona Gremi	1,230	311	25.31	763	311	40.83	1,285	1,230	55	FE
11 (298)	"Shqyrtimi i faktorëve që ndikojnë në stilin e jetesës të studentëve në Universitetin e Elbasanit; Promovimi i një stili jetese të shëndetëshme" - Ph.D. Armela Kapaj	1,500	303	20.17	930	303	32.54	1,500	1,500	0	FSHMT
12 (299)	"Ura ndërlidhëse në fushat e Shkencave të Natyrës dhe Mjekësore Teknike për Hulumtim e Zhvillim Struktural të "Zinxhirit për Kërkim Integral në Shkencë dhe Jetë - ZKISHJ"" - Dr. Dhurata Valera	1,700	398	23.40	1,054	398	37.74	1,750	1,700	50	FSHN
13 (304)	"Praktikat prindërore dhe cilësia e të nxëniet në arsimin bazë pas periudhës Covid-19" - Dr Ardian Tana	950	194	20.46	589	194	32.99	1,075	950	125	FSHE
14 (307)	"Impakti i bullizmit mbi zhvillimin psikosocial të moshave shkollore.Ngritja e kapaciteteve njerëzore." - Prof. As. Dr. Lindita Durmishi	400	70	17.53	248	70	28.27	400	400	0	FSHE
15 (308)	"Shëndeti mendor te prindërit e fëmijëve me Çrregullim të Spektrit të Autizmit" - Dr. Ortenca Kotherja	2,000	451	22.56	1,240	451	36.39	2,090	2,000	0	FSHMT
16 (310)	"Hartëzimi i zonave të ndotura (hot spots) në qytetin e Elbasanit dhe identifikimi i metodave të rikuperimit të gjelbërt (green recovery)" - Prof. as. Dr. Elvira Fetahu	2,340	382	16.34	1,451	382	26.35	3,265	2,340	925	UE
	Shuma	23,144	14,103	60.93	12,503	8,045	64.35	25,331	23,144	2,107	



Tabela 6		Projekte Kërkimi shkencor viti 2023 Realizuar nga të ardhurat UE						000/Lekë
Nr. (PBA)	Emërtimi projektit	UE						Njesia
		Gjithsej		Art. 230		Art. 602		
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
1 (68)	Ndërtimi i Database-s së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje	18,000	12,319	0		18,000	12,319	UE
2 (82)	Kërkim shkencor - projekte te ndryshme 602	3,264	0	0		3,264	0	UE
3 (82)	Kërkim shkencor - projekte te ndryshme 606	4,456	0	0		4,456	0	UE
4 (150)	"Fjalë dhe shprehje për çdo rast" - Prof. Dr. Abdulla Ballhysa	400	0	0		400	0	FSHH
5 (178)	"Studim mbi përpuethshmërinë e planeve mësimore që ofron Financë - kontabiliteti me nevojat që ka tregu" - Prof. As. Dr. Altin Idrizi	500	0	0		500	0	FE
6 (187)	"Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor" - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	900	717	0		900	717	FSHE
7 (210)	"Konferencë për shkencat sociale" - Prof.As.Dr. Elisabeta Osmanaj	800	0	0		800	0	FSHE
8 (218)	"Matja e temperaturës së trupit: krahasimi i teknikave më të përdorura në moshat pediatrike në Shqipëri dhe Itali"- Prof.As.Dr. Shkëlqim Hidri	2000	0	0		2000	0	FSHMT
9 (231)	"Elbasani në vitet 1945-1955 -dokumente arkivore " - Prof. As. Dr. Majlinda Peza, Dr. Florenca Stafa	633	435	0		633	435	FSHH
10 (256)	"Veprat penale lidhur me COVID-19" - Prof.As. Rezarta Tahiraj	400	0	0		400	0	FE
11 (269)	"Sipërmarrësit e rinj në sektorin e turizmit natyror, modeli i tyre lidhës." - Dr. Teuta Hazizi	400	327	0		400	327	FE
12 (271)	"Vlerësimi i praktikave profesionale përmes hartimit të një kornize kompetencash profesionale për studentët kandidatë për mësues." - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	190	160	0		190	160	FSHE
13 (275)	"Tipat kumutuesorë të fjalive në gjuhën shqipe" - Dr. Resul Telhaj	400	0	0		400	0	FSHH
14 (278)	"Evidentimi e vlerësimi floristik i Parkut Kombëtar "Shebenik" si dhe ngritja e kapaciteteve bashkëpunuese me Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan.." - Dr. Ermelinda Gjeta	406	332	0		406	332	FSHN
15 (279)	"Mbi studimin dhe vlerësimin e shëndetit mendor në periudhën post COVID, në grupmoshat 15-24 vjeç." - Dr. Gjergji Koja	550	215	0		550	215	FSHMT
16 (281)	"Ditët Europiane në UE" - Prof. As. Dr. Peçi Naqellari	300	0	0	0	300	0	UE
17 (282)	Konferenca e 2-të Ndërkombëtare Studentore "Sfidat e gjeneratave të reja për një të ardhme të qëndrueshme"- prof as. Dr. Elvira Fetahu	1700	1665	0	0	1700	1665	UE



Nr. (PBA)	Emërtimi projektit	UE						Njesia
		Gjithsej		Art. 230		Art. 602		
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
18 (285)	“Konferenca 12-të mjekësore ndërkombëtar në specialitete” - Prof. as. Dr. Shkëlqim Hidri	2300	0	0	0	2300	0	FSHMT
19 (286)	“Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore dhe profesioneve mjekësore teknike. Aspekte krahasimore Shqipëri-Itali” - Dr. Gjergji Koja	3000	922	0	0	3000	922	FSHMT
20 (287)	Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe ndikimi i tij në shëndetin e banorëve në qytetin e Elbasanit - Dr. Marilda Osmani	357	0	0	0	357	0	FSHMT
21 (296)	“Identifikimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë në performancën akademike të studentëve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" bazuar në mënyrën e zakoneve apo të sjelljes së të mësuarit, strategjitë e përmirësimit” - Dr. Liljana Ramasaço	115	0	0	0	115	0	FSHMT
22 (297)	"Rritja e ndergjegjesimit te edukimit financiar tek të rinjte në Qarkun e Elbasanit " - Dr Eliona Gremi	55	0	0	0	55	0	FSHMT
23 (299)	"Ura ndërlihdhëse në fushat e Shkencave të Natyrës dhe Mjekësore Teknike për Hulumtim e Zhvillim Strukturor të "Zinxhirit për Kërkim Integral në Shkencë dhe Jetë - ZKISHJ” - Dr. Dhurata Valera	50	0	0	0	50	0	FSHMT
24 (304)	"Praktikat prindërore dhe cilësia e të nxëniet në arsimin bazë pas periudhës Covid-19" - Dr Ardian Tana	125	0	0	0	125	0	FSHMT
25 (310)	“Hartëzimi i zonave të ndotura (hot spots) në qytetin e Elbasanit dhe identifikimi i metodave të rikuperimit të gjelbërt (green recovery)” - Prof. as. Dr. Elvira Fetahu	925	0	0	0	925	0	FSHMT
26 (314)	“Qendra e stimulimit të avancuar” - Dr. Elona Gaxhja	5454.4	0	0	0	5454.4	0	FSHMT
27 (323)	Java e dytë ndërkombëtare Erasmus + në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Kulturë dhe Komunikim.- prof as. Dr. Elvira Fetahu	1000	730	0	0	1000	730	UE
28 (324)	Konferencë ndërkombëtare me temë: “Sfidat e fundit në inovacionin e sipërmarrjes dhe kuadrin ligjor” - Prof.As. Imelda Sejdini	800	623	0	0	800	623	FE
	Totali	49,480	18,445	0	0	49,480	18,445	



Tabela nr. 7		Projekte huaja - UE viti 2023 - Fakti											000/lekë		
Nr.	Emërtimi i projektit	Gjendja në fillim	Plan			Fakt			Shpenzime (Lekë)						Gjendja në fund
			Disbursuar		Totali Lekë	Disbursuar		Totali Lekë	Plan			Fakt			
			EUR	Lekë		EUR	Lekë		korente	kapit	Total	korente	kapit	Total	
1	Profesionet e sportit – Shkollimi, Punësimi, Zhvillimi në Rajonin e Ballkanit	94	6,040	693	787	6,112	700	794	787	0	787	794	0	794	0
2	T@SK- Drejt ngritjes së ndërgjegjësimit, përgjegjësishë dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale	31	16,244	1,864	1,895	9,340	1,086	1,117	1,895	0	1,895	1,116	0	1,116	0
3	E-VIVA-Përmirësimi dhe vlerësimi i kompetencave të lidhura me shërbime në mjedise të ndryshme të të mësuarit në Universitetet e Ballkanit Perëndimor	191	4,339	498	689	6,159	629	819	660	0	660	643	0	643	176
4	VALEU-X,-Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare	106	23,016	2,641	2,747	15,978	1,728	1,834	2,633	0	2,633	1,787	0	1,787	47
5	BEKSTONE-Platforma e sipërmarrjeve të Arsimit të lartë për nxitjen, modernizimin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në vendet e Ballkanit Perëndimor	2,535	9,748	1,119	3,654	0	0	2,535	3,007	647	3,654	1,047	0	1,047	1,488
6	EntrAL - Aftësitë sipërmarrëse për një edukim modern në Shqipëri	2,098	21,122	2,424	4,521	18,268	1,932	4,030	3,948	574	4,521	3,474	554	4,028	2
7	EAAABAC - Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafritimit të legjislacionit, sfidat e Shqipërisë	0	150,980	17,325	17,325	16,684	1,805	1,805	17,096	230	17,325	1,247	0	1,247	558
8	NEET HORIZONS-Horizonte të reja për të rinjtë e papunë, të paarsimuar dhe të patrajnuar	0	20,128	2,310	2,310	20,997	2,428	2,428	2,310	0	2,310	1,982	0	1,982	445
	Shuma	5,054	251,618	28,873	33,927	93,537	10,308	15,362	32,335	1,450	33,785	12,092	554	12,645	2,717



Tabela nr. 8		Investimet e kryera në laboratore, mjete didaktike, fond libri për bibliotekën e pajisje të tjera- Fakti								000/lekë	
Nr.	Emërtimi i projektit	Para krijimit të BA		Pas krijimit të Bordi Administrimit							
		Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
I	Pajisje laboratorike e didaktike	14,990	23,521	26,057	19,201	12,722	36,771	35,417	19,250	9,575	
1	Laboratorë me pajisje kompjuterike	14,990	9,057	9,446	3,381	7,404	13,568	24,971	16,665	5,392	
2	Pajisje e orendi për auditore laboratore	0	14,464	7,267	1,043	3,949	8,273	4,676	1,625	4,003	
3	Pajisje laboratorike didaktike	0	0	9,344	14,777	1,368	14,930	5,770	960	180	
II	Biblioteka	293	1,819	58	4,813	4,641	2,729	2,713	47,760	347	
1	Fond Libri - blerje	0	0	0	4,686	763	652	1,101	1,755	0	
2	Fond Libri dhurata	97	190	0	0	1,655	73	260	165	347	
3	Pajisje e softe digitale	196	1,629	58	127	2,223	2,004	1,352	45,840	0	
III	Mjete transporti	0	0	0	7,620	0	0	0	0	0	
1	Automjet Mini Bus - (8+1)	0	0	0	3,209	0	0	0	0	0	
2	Automjet 4+1	0	0	0	4,411	0	0	0	0	0	
IV	Projekte të huaja	0	1,402	89	1,460	9,990	8,218	4,628	451	248	
1	Pagesë TVSH për investime	0	0	0	0	1,661	1,333	771	334	130	
2	Pajisje për projektet e huaja	0	1,402	89	1,460	8,329	6,885	3,856	118	118	
	Shuma	15,283	26,742	26,204	33,093	27,353	47,718	42,758	67,462	10,170	



C. Planbuxheti vjetor 2024

Hartimi i planbuxhetit të vitit 2024 është bazuar në projektet e paraqitura në periudhën e hartimit të p/buxhetit 2024-2026, në ndryshimet e ndodhura pas miratimit të tij; strukturën organizative, programet e studimit, numrin e studentëve të regjistruar në vijimësi, numrin e studentëve të padiplomuar, realizimit të planbuxhetit të mëparshëm, fondeve të trashëguara të përdorura nga vitet e mëparshme, nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit. Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit të funksionimit të Universitetit, përbën buxhetin e vitit 2024 në vlerën **2,392,741 mijë lekë**. Buxheti paraqetet në mënyrë analitike si më poshtë:

Fonde të mbartura, financimet, Granti dhe të ardhurat për vitin 2024 Plani				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2023	Financim viti 2024	Panbuxheti i vitit 2024
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	677,793	1,036,360	1,714,152
2	Disbursimet për projektet me financim të huaj	2,717	26,735	29,452
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	484,136	165,000	649,136
TOTALI		1,164,647	1,228,094	2,392,741

Buxheti i ndarë, sipas periudhave të financimit;

- Fondet e trashëguara të përdorura nga vitet e mëparshme në vlerën **1,164,647 mijë lekë**,
- Hyrjet e fondeve për vitin 2024 në vlerën **1,228,094 mijë lekë**.

Buxheti i ndarë, sipas formave të financimit;

- Financimi nga Buxheti i Shtetit në vlerën **1,714,152 mijë lekë**.
 - Fondi i mbartur nga vitet e mëparshme është në vlerën **677,793 mijë lekë**,
 - financimi për vitin është në vlerën **1,036,360 mijë lekë**.
- Disbursimet nga projektet me financim të huaj në vlerën **29,452 mijë lekë**.
 - Projektet e huaja në bankën e nivelit të dytë, janë me gjendje bankare në vlerën **2,717 mijë lekë**
 - Parashikohet të disbursohen gjatë vitit në vlerën **26,735 mijë lekë**.
- Të ardhurat e vetë institucionit në vlerën **649,136 mijë lekë**.
 - Të ardhurat e vetë institucionit të trashëguar janë në vlerën **484,136 mijë lekë**. *Sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit Elbasan fondi i përdorur në vitin 2023 nga të ardhurat e vetë institucionit të çelura për përdorim, si edhe të ardhurat e grumbulluara gjatë vitit të paaautorizuara. Këto fonde, sipas përcaktimeve në udhëzim janë proceduar për përdorimin e tyre në vitet pasardhëse.*
 - Parashikuar të grumbullohen të ardhura në vlerën **165,000 mijë lekë**.

1. Buxheti i mbartur nga vitet e mëparshme dhe hyrjet e fondeve për vitin 2024

Buxheti i Universiteteve publike përbëhet nga financimet (fondet) në fomën e granteve, disbursimeve nga institucione të ndryshme (ndërkombëtare, publike apo biznese private) dhe të ardhurat e vetë institucionit:

1.1. Buxheti i mbartur nga vitet e mëparshme: Fondet e mbartura nga viti 2023 janë në vlerën **1,164,647 mijë lekë** dhe janë të disponueshme për përdorim në Degën e Thesarit dhe në Bankën e Nivelit të Dytë (projektet me financim të huaj) dhe përbhet nga:

- Fonde të mbartura të financuara nga Buxheti i Shtetit në vlerën **677,793 mijë lekë**. Këto fonde janë për projektet e kërkimit shkencor (PKKZH) në proces, të financuara nga AKKSHI në vitin 2023.
- Fondet e projekteve me financim të huaj të depozituara në bankën e nivelit të dytë. Këto fonde në vlerën **2,717 mijë lekë**, përfaqësohen nga gjendja në bankë në fund të vitit në

llogarinë speciale të secilit projekt në monedhën vendase (*mbartja e fondeve nga viti paraardhës në vitin korent, bazohet në aktet e cituara më lart*).

- Të ardhurat e trashëguara të institucionit (Universitetit) në vlerën **484,136 mijë** lekë;
 - të autorizuar për përdorim gjatë vitit në artikuj të ndryshëm buxhetor e të papërdorura në vlerën **384,879 mijë** lekë,
 - të grumbulluara gjatë vitit 2023 dhe të pa autorizuar për përdorim në vlerën **99,257 mijë** lekë;

1.2. Hyrjet e fondeve për vitin 2024 janë në vlerën **1,228,094 mijë** lekë, të cilat përfshijnë

- Fondet e financuara nga Buxheti i Shtetit të cilat janë në vlerën **1,036,360 mijë** lekë; fondet e miratuara dhe të depozituara për përdorim në Degën e Thesarit në vlerën **1,036,360 mijë** lekë (detajuar me VBA nr. 1 datë 05.01.2024)
- Parashikimi i disbursimit nga donatorët për projektet me financim të huaj në vlerën **26,735 mijë** lekë (bazuar në marrëveshjet për secilin projekt);
- Të ardhurat të institucionit të parashikuara për tu grumbulluar në vlerën **165,000 mijë** lekë.
- **Financimi nga Buxheti i Shtetit.** Financimi nga Buxheti i Shtetit, bazohet në aktet për financimin e Arsimit të Lartë dhe për vitin 2024 është në vlerën **1,714,152 mijë** lekë nga i cili, fond i mbartur nga vitet e mëparshme është në vlerën **677,793 mijë** lekë dhe financimi për vitin është në vlerën **1,036,360 mijë** lekë. Financimi nga Buxheti i Shtetit përbëhet nga; Granti konkurrues për investime, Granti për kërkimin shkencor - AKKSHI, TVSH për projektet me financim të huaj, Granti për mësimdhënie e transferta tek individët, Granti i bursave të studentëve të ciklit të parë, Granti për mbështetje financiare nga fondi ekselences. MAS me (Email) datë 04.01.2024 në të cilin jepen fondet e miratuara për vitin 2024 (shkresa nr. 6 prot, datë 04.01.2024), për efekt të ndjekjes së likuiditeteve në fushën e menaxhimit në vlerën **1,036,360 mijë** lekë, fonde të cilat janë detajuar për përdorim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në Degën e Thesarit Elbasan), sipas VBA nr. 1, datë 05.01.2024 “Për detajimin e fondeve (shpenzime korente) të miratuara për vitin 2024”.

Financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2024				000/ lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2023	Financim viti 2024	Panbuxheti i vitit 2024
1	Granti mësimdhënies	672,586	919,000	1,591,585
2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	40	117,360	117,400
3	Mbështetje financiare nga fondi ekselences	0	0	0
4	Granti Konkurrues	0	0	0
5	Granti Kërkimit shkencor PKKZH	5,167	0	5,167
6	Granti Kërkimit shkencor infrastruktura PIKSH	0	0	0
7	TVSH- Projekte të huaja	0	0	0
TOTALI		677,793	1,036,360	1,714,152

Sipas të dhënave në tabelën e mësipërme financimi nga Buxheti i Shtetit ndahet në:

- Granti për mësimdhënie në ciklin e parë të studimeve është në vlerën **1,591,585 mijë** lekë nga i cili,
 - fond i mbartur nga vitet e mëparshme është në vlerën **672,586 mijë** lekë
 - financiar për vitin është në vlerën **919,000 mijë** lekë.
- Granti i bursave të studentëve të ciklit të parë – fondet për bursat financiare është në vlerën **117,400 mijë** lekë, nga i cili;
 - fond i mbartur nga vitet e mëparshme është në vlerën **40 mijë** lekë



- financiar për vitin është në vlerën **117,360 mijë** lekë.
- Mbështetje financiare nga fondi ekselences – fondet për bursat për mbështetje financiare nga fondi i ekselencës është në vlerën 0 mijë lekë.
- Granti konkurrues – për projektet e investimeve nga Buxheti i Shtetit. Deri në këtë periudhë nuk ka financime aktive në Degën e Thesarit, financimi është akorduar për vitet në vijim në vlerën 508,000 mijë lekë në të cilin është detajimi i financimit të objektit “Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjekësore teknike – FSHMT – Universiteti Elbasan”.
- Granti i kërkimit shkencor – AKKSHI është në vlerën **5,167 mijë** lekë nga i cili;
 - fond i mbartur nga vitet e mëparshme është në vlerën **5,167 mijë** lekë,
 - për vitin në vijim është pa u akorduar fondi në vlerën **8,965 mijë** lekë për 8 Projekte Kombëtare për kërkim dhe Zhvillim - PKKZH të miratuara nga Bordi i AKKSHI-t në vitin 2023.
- Granti Kërkimit shkencor infrastruktura - PIKSH nuk është çelur, si dhe nuk trashëgohet në vitet paraardhëse. Bordit i AKKSHI-it në vitin 2023 ka miratuar 2 projekte të Kërkimit shkencor infrastruktura - PIKSH me vlerë **31,785 mijë** lekë. Fondet për këto projekte riçelen në vitin pasardhës, nëse kontratat e lidhura shtrihen në këtë vit. Nuk ka filluar aplikimi për konkurrim i Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor – PIKSH.
- TVSH për projektet me financim të huaj finanohet gjatë vitit buxhetor rast pas rasti, në momentin e zbatimit të projektit, pasi janë emetuar faturat fiskale me TVSH të blerjeve apo shërbimeve në kuadër të projektit. Për vitin 2024 nuk është përlogaritur fond TVSH-je për projektet me disbursim nga donatorë të huaj.
- **Disbursimet nga projektet me financim të huaj.** Financimi i projekteve të huaja në formën e disbursimeve kryhet në bazë të ratifikimit të marrëveshjeve nga Parlamenti apo Qeveria Shqiptare me institucionet Ndërkombëtare e kryesisht Bashkimin Evropian. Për IAL-t në Republikën e Shqipërisë, këto projekte janë kryesisht kërkimore shkencore apo bashkëpunimi akademik me universitetet e huaja. Aplikimet për projekte, në kuadër të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorë të huaj, kryhet nga njësitë bazë (departamentet) të Universitetit dhe koordinimi me donatorin është i drejtpërdrejtë. Ky aspekt monitorohet dhe ndiqet nga MFE nëpërmjet njësisë kryesore të Universitetit, në zbatim ta akteve nënligjore për këtë qëllim. Disbursimi i fondeve bëhet në formë direkte në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë, e cila të autorizon kryerjen e veprimeve në një bankë të nivelit të dytë, ose të disbursimit indirekt duke mbuluar shpenzime të ndryshme për investime në pajisje, të mbulimit të shpenzimeve të mobiliteteve të stafit akademik apo studentëve.

Disbursimet e projekteve me financim të huaj për vitin 2024				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Të mbartura	Disbursimet e vitit	Totali
1	Disbursime të huaja për shpenzime korente	2,717	26,735	29,452
2	Disbursime të huaja për investime	0	0	0
TOTALI		2,717	26,735	29,452

Financimi i disbursimeve të huaja për vitin 2024 është në vlerën **29,452 mijë** lekë gjithsej, i përbërë nga;

- fonde të mbartura gjendje në bankë në fillim të vitit në vlerën **2,717 mijë** lekë
 - disbursimet e parashikuara gjatë vitit në vlerën **26,735 mijë** lekë
- Projektet me disbursim të huaj për vitin 2024 janë parashikuar me këto forma shpenzimi:

- Disbursimi për shpenzime korente për të mbuluar pagat e stafit trajnues, shpenzime operative për kosto udhëtimi e qëndrimi jashtë vendit, bursat për studentët në universitete të huaja etje, me vlerë **29,452 mijë** lekë
 - Disbursimi për investime në pajisje të ndryshme të planifikuara në kuadër të misionit të projektit me vlerë **0 mijë** lekë.
- **Të ardhura të institucionit.** Fondet të kushtëzuar - të ardhurat e institucionit arkëtohen në bazë të akteve ligjore mbi të cilat është marrë vendim nga Bordi i Administrimit për tarifën e shkollimit dhe tarifave të tjera që arkëtohen nga studentët, apo shërbime ndaj të tretëve. Këto të ardhura përdoren për financime të aktivitetit akademik, kërkimin shkencor, apo zhvillimin e infrastrukturës kërkimore akademike të Universitetit. Në planifikimin e grumbullimit të ardhurave janë marrë; të dhënat mbi numrin e studentëve, tarifën e shkollimit, sipas niveleve të studimit për vitin akademik 2023-2024.

Të ardhurat e institucionit për vitin 2024 – financime të aktivitetit akademik				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Të mbartura	Të parashikuara	Gjithsej
1	Të ardhura për shpenzime korente	70,599	46,059	116,658
2	Të ardhura për Mbështetje financiare nga fondi ekselences	0	9,000	9,000
3	Të ardhura për investime	382,503	76,816	459,319
4	Të ardhura për kërkim shkencor	31,034	29,853	60,887
TOTALI		484,136	165,000	649,136

Të ardhurat e institucionit për vitin 2024 e në vijim, janë në vlerën **649,136 mijë** lekë, nga të cilat, sipas kohës së arkëtimit janë:

- Të ardhurat e grumbulluara e të papërdorura në vitet e mëparshme në vlerën **484,136 mijë** lekë

- Të ardhurat e parashikuara t'u arkëtuar në vlerën **165,000 mijë** lekë

Të ardhurat e institucionit për vitin 2024, sipas përdorimit në aktivitetin akademik janë:

- Të ardhura për shpenzime korente në vlerën **116,658 mijë** lekë, përbëhen nga;
 - fondi i mbartur nga vitet e mëparshme në vlerën **70,599 mijë** lekë,
 - financimi nga të ardhurat e vitit në vlerën **46,059 mijë** lekë.
- Të ardhura për Mbështetje financiare nga fondi ekselences në vlerën **9,000 mijë** lekë, përbëhen nga;
 - fondi i mbartur nga vitet e mëparshme në vlerën **0 mijë** lekë,
 - financimi nga të ardhurat e vitit në vlerën **9,000 mijë** lekë.
- Të ardhura për investime në vlerën **459,319 mijë** lekë, përbëhen nga;
 - fondi i mbartur nga vitet e mëparshme në vlerën **382,503 mijë** lekë,
 - financimi nga të ardhurat e vitit në vlerën **76,816 mijë** lekë.
- Të ardhura për kërkim shkencor prej **60,887 mijë** lekë, përbëhen nga;
 - fondi i mbartur nga vitet e mëparshme në vlerën **31,034 mijë** lekë,
 - financimi nga të ardhurat e vitit në vlerën **29,853 mijë** lekë.

Të ardhurat e institucionit që parashikohet të grumbullohen për vitin 2024 janë në vlerën **165,000 mijë** lekë. Këto të ardhura parashikohen kryesisht nga:

- Pagesa për kreditet e mbartura të studentëve që kanë përfunduar vitet e përcaktuara të programit të studimit, por nuk janë diplomuar, kryesisht studentët që kanë përfunduar; vitin e dytë në programet me karakter profesionale, vitin e tretë në programet e Ciklit të parë Bachelor, vitet përkatëse të studimit në Ciklin e dytë.
- Shpërndarja librezave e diplomave.


- Tarifa e regjistrimit të studentëve të parashikuar për regjistrim në vitin akademik 2024 – 2025
- Tarifa konkurrimit të parashikuar për vitin akademik 2024 – 2025
- Të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve (janë parashikuar për 2 mjedise, një Bar kafe, pa tregtim pije alkoolike dhe një Librari Universitare, si dhe pagesat për mjediset që përdoren për kurset e gjuhëve të huaja, të cilat kryhen nga shoqata të licensuara.)
- Të tjera të ardhura (shërbime laborator, vërtetime diplomimi, certifikatë notash etj.)


Në tabelë paraqiten më të detajuara të ardhurat, sipas burimeve të krijimit dhe detajimit të përdorimit të tyre me grupime të formës së shpenzimeve.

Të ardhurat e vetë institucionit për vitin 2024 - Plani			000/Lekë		
Krijimi			Përdorimi		
Nr.	Emërtimi	Lekë	Nr	Emërtimi	Lekë
1	Qira	350	1	Studime e projektme-230	2,500
2	Programe karajter professional-Pkp	7,538	2	Patenta, soffte kompjuterike-230	2,000
3	Program Bachelor - Bach	41,561	3	Investime trupëzuara-231	274,219
4	Program Integruar - PiMs	3,795	4	Paga e shperblime-600	73,453
5	Master profesional - Mp	36,924	5	Sig. Shoqërore-601	4,855
6	Master i shkencave - Msh	54,538	6	Shpenzime operative-602	19,019
7	Program formimi vazhduarl - Pfv	595	7	Transf. me jashtë-605	900
8	Doktoraturë - Dr	5,850	8	Transf. tek individet -606	18,396
9	Trajnim mësues	200	9	Mbeshtetje financiare ekselent-606	9,000
10	Libreza Diploma	2,000	10	Kërkimi shkencor-231	5,811
11	Lëshim dokumenti	3,000	11	Kërkimi shkencor-602	50,620
12	Taksë regjstrimi	4,199	12	Kërkimi shkencor-606	4,456
13	Tarifa konkurimi	500	13	Projekte te huaja	3,272
14	Tjera - shërbime	1,950	14	Transferohen në buxhet	35
15	Pjesm. konferenca	1,500			0
16	Sponsorizime	500			0
a.-	Të ardhurat e vitit 2024	165,000	a.-	Shuma e pëdorimit	468,536
b.-	Trashëguar nga viti 2023	484,136	b.-	Trashëgohen vitet pasardhëse	180,600
	TOTALI	649,136		TOTALI	649,136

Sipas ndarjeve kryesore në të ardhurat e institucionit peshën specifike e zënë:

- Tarifat e shkollimit janë 91.⁵⁰ % e të ardhurave gjithsej,
- Tarifa regjistrimi janë 2.⁵⁰ % e të ardhurave gjithsej,
- Tarifa konkurrimit janë 0.³⁰% e të ardhurave gjithsej,
- Qira janë 0.²⁰% e të ardhurave gjithsej,
- Sponsorizime 0.³⁰ % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga shërbimet e tjara janë 5.¹⁰ % e të ardhurave gjithsej,





Të ardhurat - viti 2024

Ndërsa sipas grupimve më të detajuara të ardhurat ndahen;

- Të ardhura nga "Qira", janë të ardhurat nga dhënia me qira e mjediseve të UE-së subjekteve të treta për shërbime ndaj studentëve dhe personelit akademik dhe zenë 0.20 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga "Programe karakter profesional-Pkp", janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit me karakter profesional dhe zenë 4.60 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga "Program Bachelor - Bach", janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit në bachelor dhe zenë 25.20 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga "Program Integruar - PiMs", janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit për diplomë e integruar e nivelit të dytë dhe zenë 2.30 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga "Master profesional - Mp", janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit në master profesional dhe zenë 22.40 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga "Master i shkencave - Msh", janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit në master i shkencave dhe zenë 33.10 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga "Program formimi vazhduar - Pfv", janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e formimit të vazhduar dhe zenë 0.40 % e të ardhurave gjithsej,

- Të ardhura nga “Doktoraturë - Dr”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit doktorantëve dhe zenë 3.50 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Trajnim i mësuesve”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të krediteve që paguajnë mësuesit e arsimit parauniversitar për trainimin profesional të tyre pranë FSHE-s dhe zenë 0.10 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Libreza Dipllloma”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifës së diplomës dhe certifikatës së notave dhe blerja e librezës së studentit që regjistrohet për herë të parë dhe zenë 1.20 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Lëshim dokumenti”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shërbimeve ndaj studentëve që kanë përfunduar studimet; vërtetim diplomimi, certifikatë notash dublikatë, programe studimi etje. dhe zenë 1.80 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Taksë regjstrimi”, janë të ardhurat nga pagesat e takasve të regjistrimit në të gjitha programet e studimit dhe zenë 2.50 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Tarifa konkurimi”, janë të ardhurat nga pagesat e tarifave të konkurimit në programin e studimit “Edukim fizik e sporte” për konkursin e pranimit dhe zenë 0.30 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Tjera – shërbime”, janë të ardhurat nga pagesa për shërbimeve ndaj tretëve kryesisht analizave që kryen Laboratori kërkinmor në FSHN, i akredituar nga institucione ndërkombëtare dhe zenë 1.20 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Pjesm. Konferenca”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifës për pjesëmarrje në konferenca shkencore, të cilët përfitojnë kredite të profesionit të tyre dhe zenë 0.30 % e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura nga “Sponsorizime”, janë të ardhurat nga sponsorizimet e institucioneve universitare ndërkombëtare në kuadrin e projekteve ERASMUS+ dhe zenë 0.30 % të ardhurave gjithsej,


Përdorimi i të ardhurave është detajuar me grup shpenzimesh, sipas natyrës së mbarëvajtjes së procesit akademik e administrativ të Universitetit dhe do të përdoren:

- Investime në infrastrukturë e pajisje në masën 58.50 %
- Studime e projektme në masën 0.50 %
- Patenta, soffte kompjuterike në masën 0.40 %
- Paga në masën 15.70 %
- Sigurime shoqërore në masën 1.00 %
- Shpenzime operative në masën 4.10 %
- Transferta tek individë; rimbursim tarifa të paguara nga studentët, dalje në pension, shpërblim raste fatkeqësie etje në masën 1.30 %
- Transferta me jashtë në masën 0.20 %
- Mbeshtetje financiare bursa ekselente në masën 1.20 %
- Kërkim shkencor në masën 12.00%
 - Kërkim shkencor shpenzime per investime (art. 231) në masën 1.20 %
 - Kërkim shkencor shpenzime operative art. 602) në masën 10.80 %
 - Kërkim shkencor transferta tek individet (art. 606) në masën 1.00 %

Në krahasim me realizimin e vitit 2023 të ardhurat e planifikuara janë në rritje, ndërsa me parashikimin në P/Buxhetin afatmesëm të vitit 2024 – 2026 të ardhurat janë planifikuar në ulje me 9.7 % e planifikimit të PBA-së për vitin 2024. Ulja vjen si rezultat:

- Reduktimi i tarifave të shkollimit ose heqja e pagesës së tyre, nga zbatimi i VKM – ve për këtë qëllim.

- Ulja e numrit të studentëve në disa programe studimi.
- Në ciklin e parë e të dytë të studimit për vitin e parë nuk janë hapur disa programe studimi, pasi nuk u plotësua numri minimal i parashikuar.



Përdorimi i të ardhurave, viti 2024

Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, kostoja e një studenti mbi bazën e të cilës referohet vendosja e tarifave të shkollimit, që duhet të paguajë studenti, rezulton më e lartë se Universitetet e tjera rajonale, ndërkohë që tarifa e shkollimit nuk mund të jetë më e lartë se kufiri maksimal i vendosur me VKM-n nr. 288 datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar.

Me vendime të Bordit të Administrimit dhe VBA nr. 10 datë 09.03.2022 “Për vendosjen e tarifave të shkollimit në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'” janë vendosuar tarifat e shkollimit, tarifat e tjera dhe afatet e pagesës, si më poshtë:

1. Tarifa konkurrimi është në vlerën 5,000 lekë për aplikant për konkuresit në Ciklin e parë të studimeve “Bachelor në edukim fizik e sporte”.
2. Tarifë regjistrimi:

- a. *Tarifa e regjistrimit në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs është në vlerën 1,600 lekë. Këtë tarifë e paguan çdo kandidat që del fitues dhe regjistrohet në një program studimi në UE.*
Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për tu regjistruar në një program tjetër brenda UE – së, të paguhet vetëm njëherë.
Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për t'u regjistruar në një Universitet tjetër, do të jetë e pakthyeshme.
- b. *Tarifë aplikimi dhe regjistrimi në ciklin e dytë të studimeve; Master profesional - Mp, Master i shkencave – Msh, Program i formimit të vazhduar – Pfv është në vlerën 2,500 lekë. Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklin e dytë në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshij konkurrimin dhe regjistrimin.*
- c. *Tarifë aplikimi dhe regjistrimi në ciklin e tretë të studimeve “Dokoratë” të jetë 5,000 lekë. Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklin e tretë në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshijë konkurrimin dhe regjistrimin.*
3. *Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të jenë:*
- a) *Në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, tarifa vjetore e shkollimit të jetë:*
- *Për program të parë studimi, në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 25,000 lekë.*
 - *Për program të dytë , në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, tarifa vjetore e shkollimit, tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 60,000 lekë.*
 - *Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi, në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, që regjistrohen në vitin e parë akademik paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 12,500 lekë.*
 - *Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet me karakter profesional – Pkp, që studiojnë në vitin e dytë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 12,500 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 25,000 lekë*
 - *Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, që studiojnë në vitin e dytë e të tretë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të*

cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 12,500 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 25,000 lekë.

- b) Në programe të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, tarifa vjetore e shkollimit të jetë:
- Për program të parë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 30,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 60,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs, që regjistrohen në vitin e parë akademik të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 15,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs, që studiojnë në vitin e dytë, të tretë, të katërt e të pestë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 15,000 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 30,000 lekë.
- c) Në programe të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional - Mp”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi në vlerën 1,000 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 1,200 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 1.
- d) Në programe të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave - Msh”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi në vlerën 1,200 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 1,400 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 2.
- e) Në programin e formimit të vazhduar, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi në vlerën 1,000 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 3
- f) Në programe të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”, tarifa e përgjithshme të jetë 450,000 lekë dhe të paguhet me këste të barabartë me nga 150,000 lekë për tre vitet e para të studimeve:
4. Studenti i shpallur, sipas rregullores së Universitetit përsëritës në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs;
- a) Në programet me karakter profesional – Pkp, i shpallur përsëritës në vitin e parë dhe vitin e dytë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajnë:
- Për program të parë studimi në vlerën 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 60,000 lekë.

- b) Në programet programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, i shpallur përsëritës në vitin e parë, vitin e dytë dhe vitin e tretë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
- Për program të parë studimi në vlerën 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 60,000 lekë.
- c) Në programet programet të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, i shpallur përsëritës në vitin e parë, vitin e dytë, vitin e tretë, vitin e katërt dhe vitin e pestë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
- Për program të parë studimi në vlerën 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 60,000 lekë.
5. Studenti që nuk përfundon studimet në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs;
- a) Në programet me karakter profesional – Pkp në fund të dytë (ka marrë 40 kredite nga viti i parë dhe ka marrë 20 kredite nga viti i dytë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin dytë, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
- për program të parë studimi në vlerën 400 lekë/ kredit,
 - për program të dytë studimi në vlerën 1,000 lekë/ kredit.
- b) Në programet programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach në fund të tretë (ka marrë 40 kredite nga viti i parë, ka marrë 40 kredite nga viti i dytë dhe ka marrë 20 kredite nga viti i tretë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin tretë, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
- për program të parë studimi në vlerën 400 lekë/ kredit,
 - për program të dytë studimi në vlerën 1,000 lekë/ kredit.
- c) Në programet e integruara master i shkencave – PiMs në fund të pestë (ka marrë 40 kredite nga viti i parë, ka marrë 40 kredite nga viti i dytë, ka marrë 40 kredite nga viti i tretë, ka marrë 40 kredite nga viti i katërt dhe ka marrë 20 kredite nga viti i pestë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin pestë, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
- për program të parë studimi në vlerën 500 lekë/ kredit,
 - për program të dytë studimi në vlerën 1,000 lekë/ kredit.
6. Studenti i Ciklit të dytë të studimeve që nuk përfundon studimet brenda kohëzgjatjes së caktuar, paguan tarifën për kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator).
7. Vlera e krediteve të mbartura të paguhet për vlerën totale të lëndëve të vlerësuara jo kaluese, menjëherë para fillimit të sezonit të parë të shlyerjes së detyrimeve mësimore. Kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese të krijuara në vijim, pas vitit të fundit akademik (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator), i shtohen detyrimeve të prapambetura dhe paguhet para shlyerjes së detyrimeve mësimore, të vitit pasardhës akademik.
8. Tarifa vjetore e shkollimit për programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs, të paguhet para fillimit të shlyerjes së detyrimeve mësimore të vitit akademik.
9. Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e dytë të studimeve, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste para shlyerjes së detyrimeve mësimore të çdo semestri.

10. *Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste të barabartë për tre vitet e para të studimeve në fillim të vitit akademik.*
11. *Studenti për programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs, që ka pezulluar studimet apo kërkon të çregistrohet (nuk ka vijuar në mësim dhe nuk ka shlyer asnjë detyrim mësimor), të mos paguajë tarifë vjetore shkollimi për këtë periudhë. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet.*
12. *Studenti i Ciklit të dytë i pajisur me numrin e matrikullimit që kërkon të çregjistrohet nga ky program studimi nuk do paguajë asnjë detyrim financiar, në rast se nuk ka frekuentuar dhe nuk i është shërbyer për shlyerjen e detyrimeve mësimore. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet*

Në fillim të çdo viti akademik evidentohen kreditet e mbartura të krijuara gjatë vitit akademik paraardhës, të cilat janë të pashlyera në fund të atij viti akademik, duke ja shtuar ato detyrimeve të pashlyera të evidentuara në vitet e mëparshme.

Bazuar në këto interpretime dhe aktet e BA-së për tarifën e shkollimit, Drejtoria ekonomike ka emetuar “Faturë për arkëtim” të tarifave të shkollimit të vitit akademik 2023-2024, sipas të dhënave të fakulteteve të paraqitura në Rektorat në formë shkresore me:

- Listat e studentëve me statusin e tyre; vitin që ndjek studimet normal apo përsëritës.
- Listat e studentëve në Programet me karakter profesional, në Ciklin e parë të studimeve dhe në Program të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, për program të parë studimi, të vitit të dytë e lart me mesataren e vitit akademik paraardhës mbi 6 (gjashtë), si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore.
- Listat e studentëve në Programet me karakter profesional, në Ciklin e parë të studimeve dhe në Program të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, me kreditet e mbartura (vlerësuar me notë negative), të cilët kanë përfunduar vitet akademike të përcaktuar në rregulloren e Universitetit dhe nuk kanë përfunduar programin e studimit e konkretisht; Programet me karakter profesional, pas përfundimit të vitit të dytë, programet e studimit Bachelor, pas përfundimit të vitit të tretë, Program të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, pas përfundimit të vitit të pestë.
- Listat e studentëve në Ciklin e dytë, me kreditet e mbartura (vlerësuar me notë negative), të cilët kanë përfunduar vitet akademike të përcaktuar në rregulloren e Universitetit dhe nuk kanë përfunduar programin e studimit.

Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.02.2020 ka miratuar Rregulloren e re të Universitetit. Në këtë rregullore, ndër të tjera, është vendosur që studenti në vitin pasardhës kalon me 20 kredite, nga 30 kredite që ishte në rregulloren e mëparshme. Në zbatim të VKM-s nr. 778, datë 26.12.2018, përsa i përket studentëve të Programit me karakter profesional, në Ciklin e parë të studimeve dhe në Program të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, për program të parë, studenti i vitit të dytë e lart duhet të ketë shlyer detyrimet e vitit paraardhës dhe të ketë mesatare mbi 6 që të përfitojë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit. Shlyerje detyrimi konsiderohet që studenti të ketë marrë 60 kredite e vitit paraardhës (kalimi me notë pozitive i të gjitha lëndëve, moduleve, praktikave të vitit paraardhës). Ky stimulim do të rriste cilësinë e diplomës nga pjesa dërmuese e studentëve. Në vendimarrjen e BA-së për tarifën e shkollimit, studentët që kanë përfunduar vitet e përcaktuara të shkollimit dhe nuk janë diplomuar janë favorizuar, duke paguar vetëm për lëndët e vlerësuara me notë negative dhe jo tarifë vjetore shkollimi, si studentë përsëritës.

Efektet në ulje e të ardhurave të llogaritura në buxhetin e vitit 2024, nga arkëtimi i pagesës së tarifave të shkollimit, sipas të dhënave për aplikimet e studentëve për reduktim dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të raportuara në BA, për të cilat është shprehur me vendim, si dhe ratet e kërkesave me të dhënat për vendimarrje, në zbatim të VKM-ve dhe akteve të tjera, që rrjedhin prej tyre, paraqiten në tabelën “Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024” dhe kanë efekt financiar në vlerën 59,602 mijë lekë:

- I. **Programe me karakter profesional - Pkp, Cikli parë i studimeve Bachelor - bach dhe Programi i integruar master i shkencave – PiMs**, me një efekt financiar në vlerën totale **52,480 mijë lekë**
 - a.1 Reduktim tarife vjetore shkollimi me 50% për studentët e programeve të studimit me karakter profesional dhe programeve të studimit bachelor që janë regjistruar në vitin 2023 në vitin e pare dhe studentët e këtyre programeve të vitit të dytë e të tretë që rezultojnë me mesatre mbi 6-të në vitin paraardhës me efekt financiar në vlerën **14,050 mijë lekë**.
 - a.2 Reduktim tarife vjetore shkollimi me 50% për studentët e programeve të studimit të integruar – PiMs, që janë regjistruar në vitin 2023 në vitin e pare dhe studentët e këtij programi në vitin e dytë e të tretë që rezultojnë me mesatre mbi 6-të në vitin paraardhës me efekt financiar në vlerën **885 mijë lekë**.
 - b.1 Përjashtimet nga tarifa vjetore e shkollimit me rezultate - Bach&Pkp me një efekt financiar në vlerën **2,050 mijë lekë**.
 - b.2 Përjashtimet nga tarifa vjetore e shkollimit me rezultate - PiMs me një efekt financiar në vlerën **780 mijë lekë**.
 - c.1 Përjashtimet nga tarifa vjetore e shkollimit me kritere tjera - Bach&Pkp me një efekt financiar në vlerën **33,425 mijë lekë**
 - c.2 Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera – PiMs me një efekt financiar në vlerën **1,290 mijë lekë**
- II. **Cikli dytë i studimeve me një efekt financiar në vlerën totale në vlerën 7,122 mijë lekë**
 - II.1. Master profesional me efekt financiar në vlerën **2,010 mijë lekë**
 - 1.1. Reduktim tarife me 50% me rezultate me një efekt financiar në vlerën **600 mijë lekë**
 - 1.2. Reduktim tarife me 50% me kritere tjera me një efekt financiar në vlerën **1,410 mijë lekë**
 - II.2. Master i shkencave me efekt financiar në vlerën **5,112 mijë lekë**
 - 2.1. Reduktim tarife me 50% me rezultate me një efekt financiar në vlerën **2,160 mijë lekë**
 - 2.2. Reduktim tarife me 50% me kritere tjera me një efekt financiar në vlerën **2,952 mijë lekë**

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik
2023-2024 - Plan 000/lekë

Nr.	DEGA	I parë		I dytë		I tretë		Total	
		Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
a.1	Reduktim tarife me 50% - Bach&Pkpr (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	540	6,750	339	4,238	245	3,063	1,124	14,050
a.2	Reduktim tarife me 50% - Integruara PiMs (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	11	165	11	165	37	555	59	885
b.1	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate - Bach+Pkpr	17	425	21	525	44	1,100	82	2,050
b.2	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate - PiMs	5	150	8	240	13	390	26	780
c.1	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera - Bach+Pkpr	483	12,075	473	11,825	381	9,525	1,337	33,425
c.2	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera - PiMs	8	240	4	120	31	930	43	1,290
I	Cikli parë i studimeve + PiMs Totali	1,064	19,805	856	17,113	751	15,563	2,671	52,480
1.1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	7	210	13	390	0	0	20	600
1.2	Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	31	930	16	480	0	0	47	1,410
II.1	Total MP	38	1,140	29	870	0	0	67	2,010
2.1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	8	288	52	1,872	0	0	60	2,160
2.2	Reduktim tarife me 50% me kritere tjera	53	1,908	29	1,044	0	0	82	2,952
II.2	Total MSH	61	2,196	81	2,916	0	0	142	5,112
II	Cikli dytë i studimeve Totali	99	3,336	110	3,786	0	0	209	7,122
	Total UE	1,163	23,141	966	20,899	751	15,563	2,880	59,602

2. Shpenzimet për vitin 2024

Buxheti i shpenzimeve të vitit 2024 mbulohet nga të hyrat e fondeve në universitet, të cilat janë aktive për përdorim në degën e Thesarit ose Bankën e nivelit të dytë, si dhe ato fonde që parashikohet të grumbullohen (të ardhurat) dhe parashikohet të disbursohen nga donatorët, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve buxhetore.

Për ndarjen e shpenzimeve, sipas zërave në nivel tre shifrorë (shih tabela 1 Plan Buxheti i Shpenzimeve për vitin 2024), jemi nisur nga:

- Ndarja e tyre në p/buxhetin e vitit 2024 duke reflektuar ndryshimet e ndodhura, pas miratimit.
- Ndryshimet e ndodhura në zbatim të akteve n/ligjore.
- Në numrin e punonjësve e kualifikimin e tyre, ndryshimet në strukturë, aktet ligjore e n/ligjore për pagesat e tyre,
- Numrin e studentëve dhe orët mësimore të pagueshme për mbulimin e procesit mësimor;

Tabela 1		Plan Buxheti i Shpenzimeve për vitin 2024				000/Lekë	
Nr	Emërtimi shpenzimit	Artik.	Grant	P/huaja	Të ardhura	Total Buxheti	
1	Paga e shperblime	600	1,122,657	0	73,453	1,196,110	
-	<i>Pagat</i>	600	1,019,604	0	71,899	1,091,503	
-	<i>Honorare - oret</i>	600	103,053	0	1,554	104,607	
2	Sig. Shoqërore	601	118,828	0	4,855	123,683	
3	Shpenzime operative	602	309,703	0	19,019	328,722	
4	<i>Transf. me jashtë</i>	605	0	0	900	900	
5	<i>Transf. individët</i>	606	40,397	0	18,396	58,794	
6	<i>Bursat financiare</i>	606	117,400	0	0	117,400	
7	<i>Fondet e ekselencës</i>	606	0	0	9,000	9,000	
8	Kërkimi shkencor		5,167	0	60,887	66,054	
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	230	0	0	0	0	
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	231	0	0	5,811	5,811	
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	602	5,167	0	50,620	55,787	
-	<i>Kërkimi shkencor</i>	606	0	0	4,456	4,456	
9	Investime	230/231	0	0	459,319	459,319	
a	Studim projektive, soffte	230	0	0	4,500	4,500	
-	<i>Studime e projektive</i>	230	0	0	2,500	2,500	
-	<i>Patenta, soffte kompjuterike</i>	230	0	0	2,000	2,000	
b	Investime trupëz.	231	0	0	454,819	454,819	
-	<i>Ndërtime të reja</i>	231	0	0	389,843	389,843	
-	<i>Rikonstruksione</i>	231	0	0	27,356	27,356	
-	<i>Instalime rrjete</i>	231	0	0	0	0	
-	<i>Makineri teknologjike</i>	231	0	0	0	0	
-	<i>Paisje profesionale</i>	231	0	0	15,000	15,000	
-	<i>Paisje inventar ekonomik</i>	231	0	0	16,120	16,120	
-	<i>Mjete transporti</i>	231	0	0	0	0	
10	Projekte të huaja	230-231-602	0	0	6,500	6,500	
-	<i>Shpenzime korente</i>	604	0	29,452	3,272	32,724	
-	<i>Shpenzime Investime</i>	231	0	29,452	3,272	32,724	
	Totali		1,714,152	29,452	649,101	2,392,706	

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Universitetit i nevojitet fond page rreth **716,279 mijë** lekë, sipas përlogaritjeve në PBA 2024-2026 me ndryshimet e ndodhura pas kësaj periudhe në; numrin e punonjësve e kualifikimin e tyre, parashikimin e orëve mësimore për vitin akademik 2023-2024, nivelin e pagave të punonjësve dhe pagesës për orët mësimore të procesit akademik. Ky fond pagash ndahet:

- për pagat mujore të personelit në vlerën **611,672 mijë** lekë
- për pagesën e orëve mësimore **104,607 mijë** lekë.

Fondi i pagave gjithsej i detajuar në Planbuxhetin e vitit 2024 është në vlerën 1,196,110 mijë lekë do të mbulojë:

- Fondin e pagave për nevoja të procesit akademik e administrativ është në vlerën 1,091,503 mijë lekë
- Fondin e pagave për pagesën e orëve mësimore të parashikuara për t'u realizuar në vitin akademik 2023-2024 nga personeli akademik është në vlerën 104,607 mijë lekë.

Fondi i pagave është detajuar të përballohet nga financimi i:

- Grantit për shpenzime korrente për paga në vlerën 1,122,657 mijë lekë
 - Paga e detyrime të tjera që lidhen me pagat 1,019,604 mijë lekë
 - Shpërblime për orët e zhvilluara në procesin akademik nga personeli akademik i brendshëm e i ftuar në vlerën 103,053 mijë lekë
- Të ardhurat e institucionit në vlerën 73,453 mijë lekë. Fondi i pagave nga të ardhurat e institucionit do të shpenzohet për:
 - Pagat e punonjësve në vlerën prej 71,899 mijë lekë.

Fondi i pagave në vlerën prej 71,899 mijë lekë, i përlogaritur për ta përballuar nga të ardhurat e institucionit është efekti i pagës së punonjësve akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si rezultat i diferencës së pagës nga kufiri maksimal (paguar me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit) me kufirin minimal (nivel i përcaktuar në VKM-t për secilën nivel të pagës). Bazuar në VKM-t për vendosjen e tarifave të shkollimit, studentët e kategorive të ndryshme përjashtohen 100% ose 50% nga pagesa e kësaj tarife. Në paragrafin e fondeve të hyra nga të ardhurat e institucionit këto efekte janë në vlerën 59,602 mijë lekë. Këto efekte financiare janë rimbursuar nga Buxheti i Shtetit në Grantin e akorduar në fillim të vitit, për rrjedhojë shpenzimet nga efektet e rritjes së pagave deri në nivelin e vlerës 59,602 mijë lekë të përballohen nga Granti për rimbursim. Fondin e shtesës së pagës (e llogaritur si diverencë e kufirit maksimal nga kufiri minimal), mbi këtë limit në vlerën 59,602 mijë lekë, të përballohet nga të ardhurat, përkatësisht;

- nga Granti për rimbursim, të përballohen efektet, deri në vlerën 59,602 mijë lekë
- nga të ardhurat e institucionit, të përballohen efektet, deri në vlerën 12,297 mijë lekë

- Shpërblime për orët e zhvilluara në procesin akademik nga punonjësit e brendshëm e të jashtëm në vlerën prej 1,554 lekë.

Pagesa e orëve suplementare dhe pedagogë të jashtëm					000/lekë
Nr	Emërtimi i pagesës	Ore	Vlera	Sig. Shoq	Shuma
1	Pagesa e pedagoqeve brendshem	74,100	76,686	12,807	89,493
2	Pagesa e pedagoqeve jashtem	25,850	26,367	4,403	30,770
-	Orë viti 2023-2024 jashtem	25,850	25,500	4,259	29,759
-	Orë viti 2022-2023 jashtem	850	867	145	1,012
3	Pagesa e pedagoqeve trajnues	1,200	1,554	260	1,814
	Totali fondi	102,000	105,474	17,614	123,088

Me fondin e pagave të planifikuar do të përballohet paga mujore për punonjësit e planifikuar sipas organikës së miratuar për 376 punonjës. Gjithashtu me këtë fond do të paguhet pagesa e orëve

suplementare mbi normën e përcaktuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë mund t’i paguhen deri në 300 orë suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës në auditor, pasi të ketë përmbushur kohën minimale vjetore të punës prej 1,536 orë.

Pranë FSHE-së me vendim të Senatit Akademik funksionon sistemi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë për të cilin me VBA nr. 4, datë 21.02.2018 “Për funksionimin e sistemit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, përcaktohen modalitetet financiare dhe pagesa për kredit të punonjësve arsimor që do të trajnohen. Fondi i pagave nga të ardhurat e institucionit është përlogaritur për të përbaluar efektet financiare nga zbatimi i VBA nr.30, datë 04.11.2022 “Për miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për secilin pozicion pune.”, pika 1), “*Miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (sipas Lidhjes nr. 1, pikës II. 2) në VKM-n nr. 647, datë 05.10.2022 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 ‘Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë’, i ndryshuar’*”. Ndërsa pika 2) e VBA-s së mësipërme, “*Burimi i financimit nga kufiri minimal deri në kufirin maksimal të përballohen nga të ardhurat që realizon UE për shërbimet ndaj të tretëve në; Laboratorin kërkimor FSHN, të ardhurat nga të tretë (të diplomuarit në këtë universitet) për programe mësimore, vërtetim note pas diplomimit (dublikatë), tarifave të aplikimit në master , tarifat e regjistrimit, qira e mjediseve etje.*”

➤ **Sigurime shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi i detajuar për sigurime shoqërore në vlerën **123,683 mijë** lekë përballon nevojat deri në fund të vitit. Krahas efektit nga rritja e pagave, për llogaritjen e këtij fondi është parashikuar edhe mundësia e rritjes së nivelit maksimal të pagës për kontribut. Fondi i sigurimeve shoqërore do të përballohet;

- nga granti në vlerën **118,828 mijë** lekë,
- nga të ardhurat e institucionit në vlerën **4,855 mijë** lekë për efektet financiare nga zbatimi i VBA-ve për këtë qëllim.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Shpenzimet operative për tu shpenzuar janë planifikuar sipas parashikimeve në p/buxhetin e vitit 2024 me disa ndryshime, duke reflektuar realizimin e procedurave të prokurimit publik në fund të vitit 2023 dhe kërkesat e paraqitura nga strukturat bazë për vitin 2024. Këto shpenzime janë planifikuar në vlerën **231,000 mijë** lekë. Ky shpenzim do të përballohet nga:

- Nga Granti shpenzime operative janë parashikuar në vlerën **211,636 mijë** lekë për përballimin e shpenzimeve të drejtpërdrejta: Ujë, energji, telefon, shërbime ruajtje, pagesa e anëtarëve të Senatit Akademik, pagesa e anëtarëve të Bordit të Administrimit e shpenzime të tjera operative, ndërko që fondi i detajuar është në vlerën 309,703 mijë lekë
- Të ardhurat e vetë institucionit në vlerën **19,364 mijë** lekë.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh.: Shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren, shpenzimet për sinjalin e internetit, shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë, shpenzime për mirëmbajtje të godinave e pajisjeve etj.. Funksionimi i sistemit të ngrohjes qendrore në tërë godinat paraqet nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Grupi “Shpenzime udhëtimi” përfshin pagesën për: udhëtim e dieta brenda vendit, jashtë vendit dhe për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren. Udhëtim e dieta brenda vendit zë një peshë specifike shumë të vogël, për shkak të përcaktimeve në VKM për këtë qëllim. Për udhëtim e dieta jashtë vendit është përlogaritur mbulimi i shpenzimeve për pjesëmarrje në zbatimin e marrëveshjeve me universitetet e huaja. Peshën kryesore në “shpenzime udhëtimi” e zënë

shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren. Detajimin për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti realizimit të vitit të kaluar, si dhe nga kërkesat për nevojat e njëjësive bazë për këto shpenzime. Sipas grup shpenzimeve të dhënat përbledhëse janë në tabelën “Shpenzime për mallra dhe shërbime (602- shpenzime operative) viti 2024”

<i>Shpenzime për mallra dhe shërbime (602- shpenzime operative) viti 2024</i>				
<i>Llog.</i>	<i>Shenime</i>	<i>Grant</i>	<i>Të ardhura</i>	<i>Totali</i>
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	11,000	360	11,360
6021	Materiale dhe shërbime speciale	13,100	600	13,700
6022	Shërbime nga te trete	97,695	1,720	99,415
6023	Shpenzime transporti + lëndë djegëse për ngrohje	7,200	240	7,440
6024	Shpenzime udhëtimi	15,000	0	15,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	35,200	240	35,440
6026	Shpenzime për qiramarrje	3,720	480	4,200
6029	Shpenzime të tjera operative	28,721	15,724	44,445
	Totali	211,636	19,364	231,000

Më të detajuar zërat e shpenzimeve janë në tabelën e mëposhtme:

<i>Tabela 3 Shpenzime për mallra dhe shërbimetë detajuara Plan viti 2024</i>				
<i>Kodi llog</i>	<i>Grup shpenzimi</i>	<i>Grant</i>	<i>Të ardhura</i>	<i>Totali</i>
602.0	Materiale zyre dhe të përgjithshme	11,000	360	11,360
6020100	Kancelari	6,400	0	6,400
6020200	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	2,200	0	2,200
6020300	Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës	0	120	120
6020400	Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale	0	120	120
6020500	Blerje dokumentacioni	2,400	0	2,400
6020900	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	0	120	120
602.1	Materiale dhe shërbime speciale	13,100	600	13,700
6021001	Uniforma dhe veshje të tjera speciale	1,800	0	1,800
6021002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e të tjera produkte agrokulturore	0	120	120
6021003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekësore	240	120	360
6021007	Libra dhe publikime profesionale	1,200	0	1,200
6021008	Materiale për mbrojtjen e tokës, bimëve dhe kafsheve nga semundjet	0	120	120
6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik	960	120	1,080
6021010	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	3,000	0	3,000
6021011	Softë informatike me karakter të përgjithshëm	1,200	0	1,200
6021099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	4,700	120	4,820
602.2	Shërbime nga te trete	97,695	1,720	99,415
6022001	Elektricitet	10,000	0	10,000
6022002	Ujë	8,000	0	8,000
6022003	Shërbime telefonike	1,500	0	1,500
6022004	Posta dhe shërbimi korrier	200	0	200
6022007	Shërbimet bankare	100	0	100
6022008	Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	65,575	0	65,575
6022009	Shërbime të pastrimit dhe gjelberimit	4,800	0	4,800
6022010	Shërbime të printimit dhe publikimit	1,200	1,600	2,800
6022099	Shërbime të tjera	6,320	120	6,440
602.3	Shpenzime transporti	7,200	240	7,440
6023100	Karburant dhe vaj	6,600	0	6,600
6023200	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	240	120	360
6023300	Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit	360	0	360



Kodi llog	Grup shpenzimi	Grant	Të ardhura	Totali
6023900	Shpenzime te tjera transporti	0	120	120
602.4	Shpenzime udhetimi	15,000	0	15,000
6024100	Udhetim i brendshem	10,000	0	10,000
6024200	Udhetim jashte shtetit	5,000	0	5,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	35,200	240	35,440
6025300	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	20,000	0	20,000
6025400	Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore,rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	5,500	0	5,500
6025500	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes	4,900	120	5,020
6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	1,200	0	1,200
6025800	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	3,600	120	3,720
602.6	Shpenzime per qeramarrje	3,720	480	4,200
6026100	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh zyra	3,600	0	3,600
6026200	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh te tjera	120	480	600
602.9	Shpenzime te tjera operative	28,721	15,724	44,445
6029001	Shpenzime per pritje e percjellje	960	1,200	2,160
6029004	Shpenzime per sigurimin e ndertesave dhe te tjera kosto sigurimi te ngjashme	1,800	0	1,800
6029006	Shpenzime kompesimi per anetaret e Parlamentit dhe zyrtare te tjera te zgjedhur	9,960	0	9,960
6029007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	360	0	360
6029008	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni	360	0	360
6029099	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	15,281	14,524	29,805
	Totali	211,636	19,364	231,000

- **Kancelari.** Blerja e kancelarive është shpenzim i vazhdueshëm në çdo vit, pasi ato janë marteriale konsumi të nevojshme për aktivitetin e Institucionit. Në këtë zë të kancelarive përfshihen edhe tonera e cartrige për printera e fotokopje, që kanë çmim të konsiderueshëm për njësi. Për vitin 2024 është parashikuar vlera 6,400 mijë lekë për kancelari dhe tonera e cartrige për printera e fotokopje.
- **Shpenzimet për mbulimin e sinjalit të internetit në godinat e UE-së.** Referuar marrëveshjes ndëruniversitare me MAS-in dhe RASH-in, sinjali i internetit prej katër vjet është ofruar nga ky i fundit. Për ofrimin e këtij shërbimi RASH-i ka kërkuar dhe kërkon pagesa kundrejt numrit të studentëve të matrikulluar, ndërkohë që nuk ka dhënë informacion se sa studentë e punonjës të universitetit kanë lidhje faktike me projektet e pretenduara se i ofron. Meqenëse RASH e ndërpreu sinjalin, Universiteti ka mbi tre vite që parashikon fonde dhe zbaton procedurat për prokurimin e shërbimit të internetit me kompani që e ofrojnë këtë shërbim në të gjitha godinat me fibra optike dhe për rrjedhojë ky sinjal ofrohet nga kompania kontraktore One Albania.
- **Shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren.** Referuar VKM-s përkatëse, institucioni mbulon vetëm shpenzimet për transportin dhe fjetjen, duke përjashtuar kështu dhënien e dietës, si për studentët, ashtu dhe për punonjësit akademikë e ndihmës që shoqërojnë studentët. Përcaktimi i këtij fondi është bërë në përputhje me parashikimet në planin mësimor të miratuara në Senatin Akademik, duke marrë në konsideratë kërkesat e departamenteve për kryerjen e ekspeditës së studentëve dhe praktikave mësimore në terren. Planifikimi i shpenzimeve për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren është në ulje për vitin 2024 nga parashikimi në PBA 2024-2026. Kjo për faktin e uljes së numrit të studentëve në këto programe studimi që zhvillohet ky proces mësimor. Kryesisht peshën kryesore për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren e ka programi i studimit “Bachelor në edukim fizik e sporte”, në zbatim të planit mësimor të skive, notit e sporteve malore.

- **Shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë.** Shërbimin e ruajtjes e sigurisë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” e ka të shtrirë në të gjithë territorin e qytetit të Elbasanit, edhe në periferi të tij (Njësia Administrative Bradashesh), sikurse është cituar në paragrafin e përgjithshëm për mjediset universitare. Aktualisht ka në administrim 12 godina: Korpusi kryesor, Rektorati, Biblioteka, Shtëpia e pritjes, tre godina në FSHMT dhe truell 1,000 m² për ndërtim, FSHH (ish materniteti), Laboratori kërkimor FSHN (metalurgji) dhe Krasta me një sipërfaqe 21 ha. Ky shërbim është kryer me 17 vëndroje nga të cilat 10 vëndroje me shërbim 24 orë, ndërsa 7 vëndroje janë me shërbim 8 orë, ndërkohë që janë vendosur 7 sisteme alarmi pa pagesë, në objekte të rëndësishme (magazinë, bibliotekë, laboratore etje.). Për këtë shërbim punojnë mesatarisht 62 punonjës shërbimi. Universiteti e ka të kontraktuar këtë shërbim me subjektin “UEVI-2015” shpk, e cila ka fituar procedurën në bazë të dokumentacionit të ofertës me marrëveshje kuadër dhe kontratës lidhur me datë 24.05.2023. Sipas rekomandimeve të KLSH për reduktimin e këtij shërbimi e kryesisht për priudhën e pandemisë Covid19, nga specialistët e sektorit të shërbimeve e prokurimeve u rishikua grafiku i tij. Skema e mbulimit me vëndroje dhe punonjës shërbimi për procedurën e vitit 2023-2024 është propozuar të kryhet me 13 vëndroje nga të cilat 9 vëndroje me shërbim 24 orë, ndërsa 4 vëndroje janë me shërbim 8 orë, ndërkohë që do të vendosen 6 sisteme alarmi, në objekte të rëndësishme (magazinë, bibliotekë, laboratore etje.). Për këtë shërbim do të punojnë mesatarisht 52 punonjës shërbimi (51.46 punonjës shërbimi). Përlllogaritja e vlerës së këtij shërbimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore për këtë qëllim, të cilët përcaktojnë pagën bazë mujore sa 150% e pagës minimale për kontribut në shkallë vendi. Nga 1 prill 2023 paga minimale për kontribut shkon në vlerën 40,000 lekë në muaj dhe preventivi për “Shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë” paraqitet;

Tabela 3/1 Ruajtja dhe siguri e mjedisëve të brendshme e të jashtme UE

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Fondi në lekë
A. Shpenzime për 9 vëndroje me 4,98 punonjës/muaj/vëndroje turni i I, II, III		
1	Shpenzime për pagë bazë	60,000.00
2	Shtesë mbi pagë për turnin II	1,263.37
3	Shtesë mbi pagë për turnin III	8,422.47
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	11,637.53
	Kostoja në muaj për një punonjës Shuma	81,323.37
	Çmimi neto pa tvsh për 9 objekte (4.98*9)= 44.82 roje/muaj	3,644,913.44
B. Shpenzime për 4 vëndroje x 1.66 punonjës/muaj/vëndroje turni I-rë		
1	Shpenzime për pagë bazë	60,000
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	10,020
	Kostoja në muaj për një punonjës Shuma	70,020
	Çmimi neto pa tvsh për 4 objekte (4* 1,66)= 6.64 ne muaj	464,933
C. Shpenzime për 6 objektet me sistem alarmi (Turni II+ Turni III)		
	Kostoja në muaj për një sistem alarmi (Turni i II dhe Turni i III,-16.00-08.00 e hënë - e premte dhe 24 orë e shtune, dielë e ditët e festave)	5,000
	Çmimi neto pa tvsh për 6 objekte x 5,000 = 35,000 në muaj	30,000
	Çmimi pa tvsh në muaj	4,139,846
	Çmimi pa tvsh (A+B+C) për 12 muaj	49,678,155
	TVSH	9,935,631
	Çmimi Neto me tvsh (A+B+C) për 12 muaj	59,613,786

Sipas preventivit të hartuar nga institucioni vlera e shërbimit për 12 muaj është **59,613,786 lekë** (me TVSH). Universitetit i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është institucion publik dhe bazuar në Ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në

Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, veprimtarinë akademike e kërkimore shkencore e kryen në mjediset e tij në të gjithë shtrirjen kohore (në çdo ditë të javës, në çdo kohë të ditës). Për këtë arsye mjediset e Universitetit janë të hapura në çdo ditë të javës;

- duke ju krijuar kushte studentëve që ti përdorin në çdo kohë të ditës mjediset mësimore e didaktike për studim.
 - duke ju krijuar kushte personelit akademik, që ti përdorë mjediset mësimore e didaktike për aktivitetin studimor e kërkim shkencor, çdo ditë të javës, në çdo kohë.
 - duke ju krijuar kushte personelit akademik studentëve që të përdorë fondin e librit në Bibliotekën Qëndrore dhe në bibliotekat e fakulteteve për aktivitetin studimor e kërkim shkencor, çdo ditë të javës nga ora 8.00 deri në orën 20.00.
 - duke ju krijuar kushte Qendrës së Shkollës së Drejtorëve (e Akredituar) të këtij Universiteti, të zhvillojë mësim me drejtorët ditët e premtë, të shtunë dhe të dielë në mjediset e Universitetit.
 - duke ju krijuar kushte fakulteteve, të këtij Universiteti të zhvillojë mësim në programin e trajnimit të mësuesve çdo ditë të javës, në çdo kohë.
 - duke ju krijuar kushte fakulteteve të këtij Universiteti të zhvillojë procesin akademik të provimeve çdo ditë të javës, në çdo kohë, sipas kalendarit të zhvillimit të provimeve.
- ***Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore e mjedise të jashtme e kaldaja për ngrohje me vlerën 25,500 mijë lekë.*** Më lart kemi përshkruar infrastrukturën ndërtimore të godinave dhe mjediseve të jashtme të Universitetit, e cila për nga shtrirja dhe sipërfaqja ndërtimore, kërkon shërbime mirëmbajtje. Në këto godina ka mbi 12 vjet që nuk janë kryer investime kapitale, përveç amortizimit vjetor të tyre. Ky proces në vite është realizuar pjesor për mungesë të fondeve për këtë qëllim, si p.sh. lysterja me bojë apo gëlqere e mjediseve të brendshme apo të fasadave. Disa mjedise janë të lyera që nga koha e ndërtimit apo rikonstruksionit, kryesisht fasadat e godinave nga viti 2008 deri në vitin 2011. Gjithashtu mirëmbajtje kërkojnë izolimi i tarracave, tubacionet e shkarkimit të ujrave të bardha, rrjetet elektrike e hidraulike, rrjetet e ngrohjes me kaldaja, mjediset e jashtme rrugë, trotuare, rrjeti i ndriçimit të jashtëm etje. Me evidentimin e problematikave për këto mjedise është parashikuar fondi në vlerën 25,500 mijë lekë.
- ***Shpenzime për mirëmbajtjen e paisjeve të zyrave, auditorëve, aparaturave, paisjeve teknike, veglave të punës, me vlerën 8,740 mijë lekë.*** Pajisjet e zyrave, auditorëve, aparaturat, pajisjet teknike, veglat e punës etje. Gjatë punës së tyre pësojnë defekte, konsum fizik dhe kanë nevojë për riparimin e tyre, për një vijimësi normale të procesit të punës. Ky shpenzim është i nevojshëm çdo vit deri në plotësimin e afateve të amortizimit e daljes jashtë funksioni të tyre. Për vitin 2024 janë parashikuar 8,740 mijë lekë nga e cila vlera 5,020 mijë lekë për mirëmbajtjen e pajisjeve të auditorëve e zyrave dhe 3,720 mijë lekë për mirëmbajtjen e aparaturave, pajisjeve teknike, veglave të punës.
- ***Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit me vlerën 1,200 mijë lekë.*** Universiteti ka në përdorim 3 mjete transporti nga të cilat 2 mjete të reja me vit prodhimi 2017, ndërsa një mjet i përdorur me vit prodhimi 1997. Këto mjete kanë nevojë për shërbime periodike, si dhe mirëmbajtje të konsumit të pjesve të amortizuara. Për shpenzime të mirëmbajtjes së mjeteve të transportit është parashikuar fondi me vlerën 1,200 mijë lekë
- ***Shpenzime për blerje karburant për ngrohje.*** Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”përbëhet nga 5 fakultete me njësitë bazë (departamente e qendra), Rektorati, Biblioteka qëndrore dhe Laboratori FSHN Metalurgji. Aktiviteti akademik dhe administrativ kryhet në 10 Godina, të cilat 8 prej tyre janë me sistem ngrohje, ku janë të vendosura 6 kaldaja. Sistemi i ngrohjes është me kaldaja të cilat punojnë me karburant (Gazoil). Gjithashtu nëpër

godina janë të vendosur 5 gjeneratorë për prodhim energjie, në raste mungese energjie elektrike, të cilët punojnë me lëndë djegëse naftë (Gazoil). Universiteti ka tre mjete transporti në përdorim të stafit akademik e administrativ, të cilat punojnë me lëndë djegëse gazoil. Gjithashtu disponohen edhe pajisje pune në dispozicion të sektorit të shërbimeve, të cilat punojnë me lëndë djegëse. Furnizimi me lëndë djegëse (Gazoil) për kaldajat, kryhet nga subjektet furnizuese me bote rast pas rasti, pasi pranë secilit objekt (kaldaje) janë vendosur depozita të nëndheshme me kapacite të ndryshme nga 500 litra deri në 5000 litra, ndërkohë që mjetet e transportit furnizohen me karta elektronike të emetuar nga subjekti furnizues. Sipas përlllogaritjeve, nevojat për karburant janë për 68,166 litra, ndërkohë që fondi në dispozicion është 6,600 mijë lekë.

- **Transferta të jashtme – Artikulli 605.** Ky grup shpenzimi përfshin planifikimin e shpenzimeve lidhur me transferta në Valutë që rrjedhin nga zbatimi i një marrëveshjeje apo kontrate ndërmjet Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” me universitete apo institucione të huaja që kanë për objekt shkëmbimin e eksperiencave në fushën e mësimdhënies apo kërkimit shkencor. Për vitin 2024 kemi parashikuar 900 mijë lekë nga të ardhurat e institucionit, nisur nga eksperiencia e viteve të mëparshme.
- **Transferta tek individë – Artikulli 606.** Ky grup shpenzimi përfshin planifikimin e shpenzimeve lidhur me transferta tek studentë për pagesat e kryera gabimisht prej tyre, si dhe rimbursimin e pagesës së tarifës së shkollimit nëse studenti përfiton nga lehtësimet nga VKM përkatëse për mbështetjen studentore, përjashtim nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit për studentë me rezultate dhe ata me kritere të tjera lehtësuese. Gjithashtu në këtë artikull përfshihet edhe shpërblimi i një page nëse punonjësi del në pension, shpërblimi në raste fatkeqësie ose shpërblime për komisione të posaçme. Fondi i përlllogaritur për këtë qëllim është 18,396 mijë lekë, i cili do të përballohet nga të ardhurat e institucionit.
- **Bursat financiare të studentëve dhe mbështetje financiare nga fondi ekselencës– Artikulli 606.** Në këtë artikull përfshihen bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve, si dhe mbështetje financiare nga fondi ekselencës për studentë të shkëlqyer dhe studentë që ndjekin studimet në fusha dhe programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar, i ndarë në:
 - **Bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve.** Fondi është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit dhe diferenca e trashëguar nga viti 2023, gjithsej vlera **123,683 mijë lekë**. Në PBA-në e viteve 2024-2026 për vitin 2024, ky fond është parashikuar për **1,305 studentë** me fond **122,040 mijë lekë**. Deri në datën 09.02.2024 janë paraqitur gjithsej 1,488 raste në ciklin e parë të studimit për program të parë studimi nga të cilat; me kërkesa në portokoll gjithsej 1,380 raste me kritere të tjera dhe janë sjellë nga njësitë kryesore (Fakultetet) dhe QSHA 108 raste me rezultate. Kërkesat e studentëve që përfitojnë bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit me kritere të tjera dhe me rezultate, janë përpunuar nga komisioni dhe janë hartuar listat përkatëse për vijimin e procedurave të mëtejshme. Deri me datë 10.02.2024 në Bordin e Administrimit janë dërguar 1,481 raste. Bordi i Administrimit ka marrë vendim përfitim burse financiare 1,268 studentë, për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1,439 studentë, janë skualifikuar për përfitim burse e përjashtim nga tarifa e shkollimit 42 raste për arsye të mosplotësimit të kritereve ose janë me program të dytë studimi. Nga kërkesat e paraqitura dhe në pritje për konfirmim nga institucionet përkatëse në zbatim të VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, janë në pritje për miratim 7 raste nga të cilat; për përfitim burse financiare 6 rast, për përjashtim nga tarifa e shkollimit 1 rast.

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë bursë financiare për vitin akademik 2023-2024

000/lekë

Nr.	DEGA	I parë		I dytë		I tretë		I katërt		Total	
		Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
a.1	Bursa financiare me rezultate - Pkp	0	0	6	540	0	0	0	0	6	540
a.2	Bursa financiare me rezultate -Bach	17	1,530	15	1,350	44	3,960	0	0	76	6,840
a.3	Bursa financiare me rezultate - PiMs	4	360	8	720	7	630	6	540	25	2,250
I	Bursa financiare me rezultate	21	1,890	29	2,610	51	4,590	6	540	107	9,630
b.1	Bursa financiare me kritere tjera - Pkp	145	13,050	87	7,830	0	0	0	0	232	20,880
b.2	Bursa financiare me kritere tjera - Bach	267	24,030	308	27,720	314	28,260	0	0	889	80,010
b.3	Bursa financiare me kritere tjera - PiMs	7	630	3	270	15	1,350	9	810	34	3,060
II	Bursa financiare me kritere tjera	419	37,710	398	35,820	329	29,610	9	810	1,155	103,950
	Bursa financiare me VBA	440	39,600	427	38,430	380	34,200	15	1,350	1,262	113,580
c.1	Në pritje për miratim - Pkp	1	90	0	0	0	0	0	0	1	90
c.2	Në pritje për miratim - Bach	1	90	1	90	3	270	0	0	5	450
c.3	Në pritje për miratim - PiMs	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
III	Bursa financiare në pritje për miratim BA	2	180	1	90	3	270	0	0	6	540
	Total Bursa Financiare UE	442	39,780	428	38,520	383	34,470	15	1,350	1,268	114,120

BA është shprehur me vendimet nr 50, datë 28.12.2023 dhe nr 5, datë 10.02.2024 “Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2023-2024”. Këto vendime janë ekzekutuar menjëherë nga Drejtoria ekonomike duke i dërguar bursat në llogarinë e studentëve. Sipas përcaktimeve në VKM-n për bursat financiare, studenti në momentin e plotësimit të kritereve të këtij vendim, paraqet kërkesën për bursë financiare në universitet dhe pas konfirmimit nga institucioni që ka lëshuar dokumentin, studenti e përfiton bursën muajin pasardhës nga paraqitja e kërkesës.

- **Mbështetje financiare nga fondi ekselencës për studentë të shkëlqyer dhe studentë që ndjekin studimet në fusha dhe programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar.** Në zbatim të VKM-s nr. 386, datë 01.06.2022 “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe udhëzimit të MAS nr. 30, datë 04.11.2022 për këtë qëllim, mbështetja financiare ju jepet studentëve të rregjistruar në vitin akademik 2023-2024, në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar. Për përfitimin e mbështetjes financiare, studenti duhet të vazhdojë studimet në program të parë studimi dhe të plotësojë kriterin e mesatares 7.50 e lartë për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar në mësuesi dhe kriterin e mesatares 6.50 e lartë në programet e tjera prioritare, por edhe në programin e studimit “Arsimi parashkollor”, i cili është cikël i mbyllur me tre vite studimi. Për mbështetjen financiare nga fondi ekselencës për studentë të shkëlqyer dhe studentë, që ndjekin studimet në fusha dhe programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar, për vitin akademik 2023 – 2024, janë miratuar 13 kuota me financim nga Buxheti i Shtetit nga Senati Akademik me Vendim nr. 3, datë 31.01.2024 “Për miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, që financohen nga AKFAL” dhe nga Bordi i Administrimit me Vendim nr. 3, datë 10.02.2024 “Për miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, që financohen nga AKFAL”. Vendimi i Senatit Akademik është dërguar në AKFAL për vijimin e procedurave dhe



7Q

Adresa: Rruga “Ismail Zyma” Elbasan,

Tel & fax: +355 542 52593,

Web: www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

lidhjen e marrëveshjeve, sipas kërkesave të VKM-s për këtë qëllim. Pas kryerjes së procedurave financohen fondet nga AKFAL për vitin akademik 2023 – 2024 për 13 studentë. Gjithashtu për vitin akademik 2022 - 2023 janë lidhur marrëveshje për përfitimin financiar ndërmjet AKFAL, Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe dy studentëve. AKFAL për vitin 2023 – 2024 ka vijuar 1 marrëveshje për përfitimin e mbështetjes financiare me studenten Paola Petrit Balliu në programin e studimit “Bachelor në biologji-kimi” në FSHN.

Bazuar në VKM-n e mësipërme të “Mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar”, strukturat akademike të Universitetit në periudhën para aplikimit të gjimnazitëve, kanë sensibilizuar maturanët për të studiuar në këto programe studimi në Universitetin e Elbasanit. Në AKFAL për vitin akademik 2023 – 2024 kanë aplikuar 38 studentë, që plotësojnë kriteret për të përfituar mbështetjen financiare, ndërkoë që AKFAL ka miratuar 13 kuaota të financuara prej tij, sikurse e cituam më lart. Në këto kushte ju propozua Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit që nga lista e aplikantëve përfitues, që plotësojnë kriteret të miratojë kërkesën për 25 studentë për financim nga të ardhurat e Universitetit. Financimi nga të ardhurat e Universitetit për “Mbështetjen financiare të studentëve në programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar” është për të sensibilizuar maturanët për të studiuar në këto programe studimi. Senati Akademik miratoi Vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 “Për miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, që financohen nga UE” dhe Bordi i Administrimit miratoi Vendimin nr. 4, datë 10.02.2024 “Për miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, që financohen nga UE” për 25 studentë përfitues. Efektet financiare nga zbatimi i vendimeve është 9,000 mijë lekë në vit, të cilat janë planifikuar nga të ardhurat e Universitetit. Procedura e financimit nga Universiteti do të realizohet pas vijimit të procedurave nga AKFAL dhe lidhjen së marrëveshjeve, sipas kërkesave të VKM-s për këtë qëllim, sikurse vepohet me mbështetjen financiare që financohet nga Buxheti i Shtetit (AKFAL).

Tabela 1/1 Mbështetje financiare nga fondi ekselences dhe të ardhurat e UE për vitin 2024 - Parashikim 000/lekë

Nr	Emërtimi i projektit	Kap	Programi	Llog. Ek.	Kod	Nr stud	Vlera	Fondi
1	Mbështetje financiare (ekselences) Viti II	8	9770	604	91106AF	1	40000	360
2	Mbështetje financiare (ekselences) Viti I	8	9770	604	91106AF	13	40000	4,680
	Fondi ekselences AKKSHI	8	9770	604	91106AF	0	0	5,040
1	Mbështetje financiare (të ardhurat e UE s) Viti I	6	9770	606	91106AF	25	40000	9,000
	Fondi ekselences UE	6	9770	606	91106AF	0	0	9,000
TOTALI								13,680

➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen nga:

- Grant konkurrues janë planifikuar dy objekte investimi për vitet 2024 – 2026 me vlerë totale **997,455 mijë** lekë, ndërsa për vitin 2024 investimet në vlerën **118,000 mijë** lekë.
- Të ardhurat e vetë institucionit për investime sipas objekteve me vlerë totale janë **734,160** mijë lekë, financimi për vitin 2024 në vlerën **438,872 mijë** lekë.
- Projektet e huaja janë planifikuar në vlerën **32,724 mijë** lekë;
 - disbursim nga donatorët në vlerën **29,452 mijë** lekë,
 - nga të ardhurat e institucionit **32,72 mijë** lekë.

Në sistemin SIFQ ngarkohet në Investime (231), ndërkohë që planifikimi dhe pagesa kryhet; për shpenzime korente vlera **32,724 mijë** lekë, investime vlera **0 mijë** lekë.

Investime viti 2024					000/ lekë	
Nr.	Emërtimi i projektit	Total	Të ardhura		Buxheti	Disb. të Huaja
			Plani 2024	Vlera totale		
I	Studime e projekttime, patenta, liçenca, soffte kompjuterike	4,500	4,500	4,500	0	0
II	Ndërtime të reja	1,660,867	209,265	661,412	999,455	0
III	Rikonstruksione	27,356	27,356	27,356	0	0
IV	Paisje inventar ekonomik	16,120	16,120	16,120	0	0
V	Paisje profesionale	15,000	15,000	15,000	0	0
VI	Mjete transporti	6,500	6,500	6,500	0	0
VII	Projekte të huaja	32,724	3,272	3,272	0	29,452
	Shuma	1,763,067	282,013	734,160	999,455	29,452

o Grant konkurrues janë fondet që përballohen nga buxheti i shtetit, të cilat deri në këto momente nuk janë akorduar fonde (çelje në degën e Thesarit). Nga Universiteti janë dërguar për konkurrim;

- Objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane - ish materniteti", dërguar për konkurrim në vitin 2018 me vlerë **699,455** mijë lekë me kontribut nga universiteti 210,000 mijë lekë nga të ardhurat, për të cilin është ngurtësuar rreth 70% të vlerës në degën e Thesarit, në momentin e dërgimit për konkurim, ndërsa nga Buxheti i Shtetit vlera 489,455 mijë lekë. Ky objekt nuk u financua gjatë viteve 2018-2023. Parashikohet të ridërgohet kërkesa për konkurrim, duke vendosur nga universiteti vlerën 30,000 mijë lekë për vitin 2023 dhe vlerën 180,000 mijë lekë në vitet në vijim.
